

**ARSIMI
FIGURATIV
PËR KLASËN**

5

Shkup, 2020

Autorë:

Danço Ordev
Igor Ordev

Recensentë:

Dr. Maja Raunik Kirkov, kryetare
Suta Topkoska, anëtare
Agim Saiti, anëtar

Përkthyes:

Fikrije Qerimi

Redaktim profesional:

Prof. Dr. Agim Poloska

Lektor i botimit në shqip:

Mr. Ismail Hamiti

Me vendim të ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë nr. 22-2326/1 datë 21.04.2010 lejohet përdorimi i këtij libri.

Botues: Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Shtyp: Evropa 92, Koçan

Tirazhi: 545

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.3.016:73/76(075.2)=18

ORDEV, Danço

Arsimi figurativ për klasën e V të arsimit fillor nëntëvjeçar /Danço Ordev, Igor Ordev. - Shkup : Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2020. - 104 стр. : илустр. ; 30 см

ISBN 978-608-226-426-4

1. Ordev, Igor [автор]

COBISS.MK-ID 111811082

Nxënës i dashur

Edhe në këtë vit shkollor do të vazhdojmë të vizatojmë, të pikturojmë dhe të formojmë krijime nga arsimit figurativ, si dhe të njoftohemi me përmbajtje të reja të arsimit figurativ.

Në secilën klasë të ardhshme do të mësojmë më tepër për gjuhën figurative, do të njoftohemi me teknika të reja të arsimit figurativ dhe me emra të rinj të artistëve të çmuar nga Maqedonia dhe bota.




Me ndihmën e librit dhe të arsimtarit tuaj shumë më tepër do ta kuptoni magjinë e shprehjes figurative dhe do të aftësoheni që t'i njihni vlerat e vërteta të artit figurativ.

Kënaquni në krijimin e veprave tuaja figurative dhe ora e arsimit figurativ le t'ju paraqet kënaqësi.

Autorët

TEKNIKA TË NDRYSHME TË ARTIT FIGURATIV

4



AUTOPORTRETE TË ARTISTËVE TË FAMSHËM FIGURATIV

5



Albreht Direr: **Autoportret**,
Vaj në pëlthurë



Elizabet le Brun:
Autoportret, Vaj në pëlthurë



Ogist Renoar: **Autoportret**,
Vaj në pëlthurë



Tintoreto: **Autoportret**, Vaj në
pëlthurë



AUTOPORTRITI IM

(emri)

(mbiemri)

(klasa)

(shkolla filllore)

(Vizatojeni autoportretin tuaj në
hapësirën e zbrazët)

Rubens: **Autoportret**,
Vaj në pëlthurë

Kamij Pisaro: **Autoportret**,
Vaj në pëlthurë



Pol Sezan: **Autoportret**,
Vaj në pëlthurë



PËRMBAJTJA

6

ARTI FIGURATIV.....	8
GJUHA FIGURATIVE	10
Vija.....	12
Ngjyra.....	14
Toni.....	18
Tekstura.....	20
Kahja	22
Madhësia.....	24
Forma-vëllimi.....	26
Hapësira.....	28
Kontrasti.....	30
Ritëm-përsëritje.....	32
Harmonia.....	34
Baraspesha.....	36
Gradacioni.....	38
Proporcioni.....	40
Bashkësia.....	42
Kompozimi.....	44
Motivi.....	46




FUSHAT FIGURATIVE.....	54
VIZATIMI.....	56
Tekstura.....	58
Forma.....	59
Hapësira.....	60
Kontrasti.....	61
Kompozimi.....	62
Tushi.....	63



PËRMBAJTJA

7



VIZATIMI.....	64
Ngjyra.....	66
Tekstura.....	68
Hapësira.....	69
Akuarel.....	70
Pastel dylli.....	71



FORMËSIM.....	72
Forma.....	76
Kontrasti.....	77
Proporcioni.....	78
Argjila.....	79



DIZAJN DHE KOMUNUKIME VIZUELE.....	80
GRAFIKA.....	84
Nënshkrim në grafikë.....	86
Vija.....	87
Tekstura.....	88
Forma.....	89



VLERËSIM ESTETIK.....	90
FJALOR NOCIONESH.....	96
TEST 1.....	99
TEST 2.....	101

ARTI FIGURATIV

8

E dimë se njerëzit merren me zanate dhe aktivitete të ndryshme që ta lehtësojnë dhe zbukurojnë jetën e përditshme dhe mbijetesën.

Artistët krijojnë punime të ndryshme të cilat e zbukurojnë kohën tonë të lirë dhe na bëjnë të lumtur dhe humanë. Ekzistojnë më shumë lloje të artit siç janë muzika, teatri, baleti, letërsia, fotografia dhe nënkuptohet edhe arti figurativ është një prej tyre.


Arti muzikor është i pandashëm prej përditshmërisë tonë dhe e plotëson çdo çast të jetës sonë.

Arti teatror është përjetim i posaçëm për secilin njeri me të cilin e pasuron jetën duke u kënaqur në aktrimin, lëvizjen, vepra dhe të folurit e aktorëve në skenë.


Secili prej nesh që ka vizituar shfaqje të baletit e di që baleti si art paraqet përjetim të veçantë të bukurisë së muzikës si dhe lëvizjeve dhe lojës së jashtëzakonshme të artistëve të baletit.



FILM



FOTOGRAFI



MUZIKË



BALET



TEATËR



VIZATIMI

Nëpërmjet televizionit ose kur shkojmë në kinema e dimë që arti i filmit vazhdimisht është prezent në kohën tonë të lirë, i cili na argëton dhe pushon. Çdo njeri ka dëshirë të lexojë ndonjë libër të mirë, e që në çdo çast është shoku i tij më i mirë. Letërsia si art e pasuron jetën tonë dhe mënyrën e të shprehurit dhe na bën më të pasur dhe më të ndryshëm prej të tjerëve.

Sot arti i fotografisë na njofton me bukuritë e gjithë asaj që na rrethon. Nëpërmjet fotografisë njoftohemi me magjinë dhe specifikën e natyrës, qyteteve, jetën e njerëzve tjerë, dhe njëkohësisht na përcjell dhe informon për ndodhitë e botës.

Arti figurativ shprehet me vizatim, pikturë, grafikë, skulpturë dhe dizajn me të cilat e zbukuron jetën tonë të përditshme me vepra magjike figurative.



SKULPTURA



GRAFIKA



DIZAJNI



FRESKA



PIKTURA

TË MBAJMË MEND:

Artet ndahen në: figurative, muzikore, balet, teatror, letrat dhe art i fotografisë.

ELEMENTET FIGURATIVE

10

Të gjitha artet i njohim sipas ndonjë specifike, muzikën sipas zërit dhe melodisë, letërsinë dhe teatrin sipas fjalës, baletin sipas lojës ndërsa filmin sipas ngjarjes. Të gjitha artet paraqiten me diçka specifike, po ashtu edhe arti figurativ. Paraqitjen e artit figurativ e quajmë gjuhë figurative. Gjuha figurative është shumë e lehtë për ta mësuar. Ajo ndahet në elemente figurative dhe parime figurative. Në këtë libër do të njoftohemi me të gjitha në veçanti, dhe nëpërmjet vizatimit, pikturimit dhe skulpturimit do t'i shprehim punimet tona figurative. Elementet dhe parimet figurative janë shumë të lehta për t'u kuptuar, dhe do të na ndihmojnë të shprehemi figurativisht, si dhe ta kuptojmë artin figurativ

Elemente figurative të gjuhës figurative janë: vija, ngjyra, toni, tekstura, kahja, madhësia, forma (vëllimi) dhe hapësira. Parimet figurative janë: kontrasti, ritmi, harmonia, baraspesha, radacioni, proporcioni, bashkësia dhe kompozimi

**VIJA**


Vija bën pjesë në elemente dhe atë e njohim si gjurmë në shtresën kur vizatojmë dhe shkruajmë.

**NGJYRA**

Me ngjyrën takohemi në çdo vend rreth nesh dhe ajo ngjyros me ngjyra të bukura çdo send që shohim dhe na rrethon.

**TEKSTURA**


Tekstura është përshkrimi i sipërfaqeve të vrazhda dhe të rrafshta të ndonjë subjekti.

**MADHËSIA**

Madhësia është element, i cili na tregon se sendet rreth nesh janë më të vogla ose më të mëdha.

**TONI**

Ton do të thotë nuanca më të ndritshme dhe më të errëta të një ngjyre të njëjtë. Ajo fitohet shumë lehtë me përzjerje të ngjyrës me të bardhë ose me të zezë.

**HAPËSIRA**

Hapësira paraqitet në fotografi. Sipërfaqe quhet e gjithë ajo nëpër të cilën lëvizim ne, zogjtë, automjetet... Bimët rriten të lira.

**FORMA**

Formën vetëm se e dimë. Të gjitha sendet si edhe ne vetë kemi formë dhe sipas saj njihemi.

**KAHJE**

Kahja është drejtim i shikimit të një vizatimi, fotografie, skulpture apo grafike.



KONTRASTI

Kontrasti është parim figurativ. Ai do të thotë diçka e kundërt sikurse ndritshëm-errët, e madhe- e vogël, lartë-poshtë, ngrohtë-ftohtë etj.




GRADACIONI

Ndoshta gradacioni është fjalë e re, mirëpo nëpërmjet tij mësojmë se si gradualisht ndryshohet ngjyra, vija, toni dhe elementet tjera në veprat figurative.



UNITETI

Uniteti si parim e rregullon veprën figurative në një tërësi të qetë.



PROPORCIONI

Proporcioni do të thotë si t'i harmonizojmë madhësitë e ndryshme në një vepër si tërësi.



BARASPESHA

Baraspesha si parim do të na tregojë se si një vepër të jetë e matur dhe radhitja në të të jetë e njëtrajtshme.



HARMONIA

Harmonia është mënyra se si ta bëjmë veprën figurative të jetë harmonike dhe e bukur.



KOMPOZIMI

Kompozim është parimi i fundit i cili na mëson se si t'i radhisim vijat, ngjyrat, tonet në veprën figurative.



RITMI

Përsëritjen ose ritmin e hasim kudo, në muzikë tonet kanë ritëm. Dita dhe nata përsëriten, javët, muajt dhe vitet poashtu, etj.

TË MBAJMË MEND:

Gjuha figurative ndahet në elemente figurative dhe parime figurative. Elemente figurative janë: vija, ngjyra, toni, tekstura, kahja, madhësia, forma dhe hapësira.

Parime figurative janë: kontrasti, ritmi, harmonia, baraspesha, gradacioni, proporcioni, uniteti dhe kompozimi.

ELEMENTE FIGURATIVE

12


VIJA

Vija është elementi themelor i gjuhës figurative me të cilin artisti shprehet, mirëpo edhe elementi i cili paraqitet kudo rreth nesh, në të gjithë atë që na rrethon, në gjësendet, natyrë dhe dukuri.

Njeriu vijën e përdor çdo ditë për nevojat e veta, me atë shkruan, paraqet forma të ndryshme, informon, shënon idetë e veta, respektivisht komunikon me rrethinën.

Të përkujtohem se vijat ndahen në *vija të lakuara*, mirëpo mund të jenë të trasha dhe të holla, të shkurta dhe të gjata.

Nëse në shprehjen tonë figurative me një vijë e përshkruajmë karakterin e jashtëm respektivisht formën e asaj që e paraqesim – atë vijë e quajmë *konturë*. Me vijën e quajtur *teksturë* paraqesim shumëllojshmërinë e materialit të sipërfaqes së gjësendeve të cilët mund të jenë të vrazhdë dhe të rrafshët, të ashpër apo të butë.



Vija në natyrë



Vija në jetën e përditshme



Vija rreth nesh




Vija në natyrë



Vizatim parahistorik, shpella Lasko



Vijë konturë




Vijë konturë



Vijë teksturë



Vizatim, thëngjill (vijë)



Vasko Tashkovski: **Ishull**, tush, pendë (vijë teksturë)

TE MBAJMË MEND:

Vija është element figurativ. Dallojmë vija të lakuara, të drejta, vija konturë dhe teksturë.

NGJYRA

E gjithë ajo që na rrethon: natyra, njerëzit, bimët, bota e gjallë, gjësendet, e gjithë ajo që e shohim kur ka dritë është e ngjyrosur me ngjyrë.

Pa dritë, artificiale apo natyrore nuk shihet ngjyra, respektivisht nuk ka ngjyrë.

Ngjyrën e hasim kudo rreth nesh dhe çdo gjë që ekziston në botë e ka ngjyrën e vet. Ngjyra shihet kur ka dritë, pa dritë nuk ka ngjyrë.

Me thyerjen e rrezeve fitohen ngjyrat e spektrit, ato janë: e kuqe, portokalli, e verdhë, e gjelbër, e kaltër dhe vjollcë. Në natyrë këto ngjyra paraqiten pas shiut dhe këtë dukuri e quajmë ylber.

Ngjyra në gjuhën figurative ndahet në disa mënyra, e para është në ngjyra primare dhe sekondare. Ngjyra primare janë e kuqe, e kaltër dhe e verdhë. Prej tyre, me përzierje secili prej nesh mund të fitojë ngjyra sekondare. Ngjyra sekondare janë: e gjelbër, portokalle dhe vjollce.




Ngjyrë në natyrë




Ngjyrë në natyrë



Ngjyrë në natyrë



Thyerja e dritës nëpërmjet prizmes optike




Cinober Karmin



Ultramarin e kaltër Pariziene



Ngjyra kromatike



Ngjyra akromatike

Artistët dallojnë shumë lloje të ngjyrave primare dhe sekondare, por ne duhet të dimë më tepër për ngjyrën e kuqe dhe të kaltër. Ngjyrën e kuqe e kemi si *cinober* dhe *karmin*, a të kaltërtën si *ultramarin* dhe *e kaltër pariziene*. Këtë duhet da dimë sepse nëse duam të fitojmë ngjyrë vjollce duhet t'i përziejmë të kuqin karmin dhe ultramarin e kaltër.

Ngjyra në gjuhën greke quhet *hroma* dhe prej kësaj fjale të gjitha ngjyrat e spektrit i quajmë *ngjyra kromatike*. Në gjuhën figurative, e bardha dhe e zeza nuk llogariten për ngjyra por shënojnë errësim ose ndriçim që u shtohen ngjyrave të tjera. Të bardhën dhe të zezën i quajmë *ngjyra akromatike*.

Ngjyrat kanë intensitet. Disa janë më të ndritshme e disa më të errëta. Kështu që ngjyrat ndahen në më të ndritshme dhe më të errëta.

Jeta e njeriut nuk mund të paramendohet pa ekzistimin e ngjyrës. Ajo i ngjyros gjësendet, veshmbathjen, ushqimin, shenjat e komunikimit dhe çdo gjë tjetër. Ngjyra ndikon në psiken e njeriut, shpeshherë duke asocuar diçka, gëzim, hare, pikëllim.



Spektër i ngjyrave (ylber)

ELEMENTENTE FIGURATIVE

16

Njeriu ndjen ngrohtësinë dhe të ftohtin në kontakt me ndonjë dukuri ose send. Ngjyrat mund të kenë ndikim tek njeriu dhe të asocojnë ndjenjë të ngrohtë dhe të ftohtë. Sipas këtij ndikimi ngjyrat ndahen në ngjyra të ngrohta dhe të ftohta. Ndikim të ftohtë kanë ngjyrat verdh-gjelbër, gjelbër, gjelbër-kaltër, kaltër, kaltër-vjollcë dhe vjollcë. Ndikim të ngrohtë kanë ngjyrat verdh-portokalle, portokalle, e kuqe dhe e kuqe-vjollcë.

Në krijimtarinë figurative ngjyrat kombinohen në mënyrë të ndryshme, si të *ngjajshme* dhe si *kontrast*. Nëse në një punim vizatojmë me ngjyra siç janë: e verdhë, portokalle dhe e kuqe ose e kaltër, ngjyrë vjollce dhe e kuqe ose e verdhë, gjelbër dhe kaltër, themi se ato ngjyra janë harmonike.

Nëse duam të vizatojmë më ngjyra të cilat janë të kundërta, atëherë themi se jemi duke vizatuar kontrast.



Iluzion në hapësirë me ngjyrë




Ngjyra të ngrohta dhe të ftohta (vepër e nxënësit)



Ngjyra të ftohta (vepër e nxënësit)




Ngjyra të ngrohta (vepër e nxënësit)



Ngjyra komplementare



Ngjyra komplementare



Ngjyra komplementare



Kontrast komplementar

Tek ngjyrat dallojmë kontraste të ndryshme në mes të cilëve më i njohur është *kontrasti komplementar*. Në këtë kontrast ngjyrat forcohen në mes veti dhe bëhen më të bukura. Ngjyra komplementare janë e kuqe dhe e gjelbër, e kaltër dhe portokalle, e verdhë dhe vjollcë.

Me ngjyrat mund të fitohet iluzion prej larg dhe afër, respektivisht mund të fitohet iluzion në hapësirë. Ngjyrat e ndritshme dhe të ngrohta veprojnë afër, ndërsa të errëta dhe të ftohta veprojnë larg në veprat figurative.



Vinsent van Gog: **Rrugë e fshatit në Avers**, vaj në pëlthurë (kontrast komplementar)

TË MBAJMË MEND:

Kemi ngjyra primare dhe sekondare. Ngjyra primare janë: e kaltër, e verdhë dhe e kuqe. Sekondare janë: vjollcë, portokalle dhe e gjelbër. Ngjyrat primare dhe sekondare janë kromatike, ndërsa e bardha dhe e zeza janë akromatike. Poashtu ngjyrat ndahen edhe në të ndritshme dhe të errëta si dhe në të ngrohta dhe të ftohta. Ngjyra komplementare janë: e kuqe dhe e gjelbër, e kaltër dhe portokalle, e verdhë dhe vjollcë.

ELEMENTENTE FIGURATIVE

18


TONI

Kudo rreth nesh ku ka dritë shihet edhe ngjyrë. Në errësirë ngjyra nuk shihet.

Shohim se disa nga ngjyrat janë më të ndritshme, e disa më të errëta. Nëse në ngjyrë ka më tepër dritë ajo ngjyrë duket më e ndritshme dhe anasjelltas, ngjyra është më e errët nëse në të ka më pak dritë. Kur ngjyra është më e ndritshme apo më e errët themi se ajo ngjyrë ka ton më të ndritshëm apo më të errët. Nëse paramendojmë se ngjyra e bardhë është dritë dhe e shtojmë në ndonjë ngjyrë tjetër do të fitojmë ton më të ndritshëm të ngjyrës së njëjtë. Nëse ngjyrën e zezë e paramendojmë si errësirë dhe e shtojmë në ndonjë ngjyrë tjetër, do të fitojmë ton më të errët. *Toni e përcakton sasinë e ndritshmërisë në një ngjyrë.*



Shkalla e toneve akromatik



Shkalla e toneve kromatik




Tone kromatike

Pol Kle: **Vdekje dhe zjarr**, tempera (tone akromatike)Zhorzh Sera: **Vizatues**, thëngjill (tone akromatike)



Toni në natyrë
(fotografia)



N. B. Kica: **Ikja e dervishit**, vaj
në pëlhurë (ton)



Sveto Manev:
Fotografia 3,
vizatim (ton)

Tomas Ginzboro:
Portret vajzash,
Vaj në pëlhurë (ton)



Ekzistojnë dy lloje të toneve, akromatike dhe kromatike. Nëse ngjyrat akromatike (e bardha dhe e zeza) i përziejnë së bashku do të fitojnë tone akromatike ngjyrë hiri. Nëse gradualisht i radhisim këto tone me errësim dhe ndriçim gradual fitohet *shkalla akromatike e toneve*.

Shkalla akromatike e toneve është e përbërë prej shumë toneve ngjyrë hiri në mes të së zezës dhe të bardhës.

Tonet përveç me përzierje të së bardhës dhe të zezës, mund të fitohen edhe me ndihmën e vijave. Nëse duam të fitojmë tone më të ndritshëm vijat shënohen më rrallë. Për tone më të errëta vijat shënohen më dendur. Shënimi i vijave mund të jetë paralel, të kryqëzuara ose në kahje të ndryshme.

Në një vepër figurative mund të përdorim tone të ndritshme dhe poashtu tone akromatike të errëta. Nëse përdorim tone shumë të ndritshme dhe shumë të errëta, fitojmë kontrast ndritshëm-errët.

TË MBAJMË MEND:

Toni është sasi e e ndritshmërisë në një ngjyrë. Dallojmë tone kromatike dhe akromatike. Tonet kromatike fitohen me përzierjen e së bardhës dhe së zezës me ndonjë ngjyrë primare ose sekundare. Tonet akromatike fitohen me përzierje të përbashkët të së bardhës dhe të zezës.

ELEMENTE FIGURATIVE

20

TEKSTURA

Gjithë ajo që është bërë rreth nesh ka sipërfaqe. Sipërfaqen mund ta shohim me sy apo ta ndjejmë me prekje. Me shikim ose me prekje mund të dallojmë se sipërfaqja është e vrazhdë apo e drejtë, e këndshme, e pakëndshme, e butë, e fortë, e lagët apo e thatë. Nëse e vizatojmë, pikturojmë apo skulpturojmë sipërfaqen e ndonjë materijeje, rezultatin e quajmë *teksturë*.

Të gjitha sendet kanë teksturë. Gjësendet mund të jenë krijuar nga natyra apo njeriu. Teksturat në gjësendet që i ka krijuar natyra themi se kanë *prejardhje natyrore*.

Njeriu prodhon shumë gjësende nga materiale të ndryshme. Së pari prodhon materiale, e pastaj prej tyre prodhon gjësende, e pastaj gjësendeve u bën tekstura të ndryshme, të vrazhda, të rrafshta, të buta, të forta dhe shumë të tjera. Ato i quajmë *tekstura me prejardhje artificiale*.



Teksturë natyrore




Teksturë natyrore në gur




Teksturë natyrore


Danço Kal'çev: **Idoli**,
vaj në dru
(teksturë në pikturim)



Teksturë me pika



Teksturë me vija



Teksturë me ngjyrë



Risto Kalçevski: **Rërë dhe gurë**, vaj në pëlhurë (teksturë në pikturim)

Artistët në vizatimet e tyre bëjnë tekstura me ndihmën e vijave. Për të paraqitur tekstura të ndryshme përdorin vija të trasha, vija të holla, të shkurta, të drejta dhe të lakuara. Vijat i vizatojnë në mënyra të ndryshme, më të rralla apo më të dendura, më të trasha apo më të holla dhe fitojnë *iluzion të teksturës*. Për atë qëllim përdoren materiale të ndryshme për vizatim.

Për paraqitje të teksturës me vijën kombinohet edhe pika. Me madhësi të ndryshme dhe dendësi të ndryshme të vendosjes së pikave mund të fitohet iluzion i vrazhdë dhe i drejtë.

Edhe skulptorët imitojnë tekstura nëpër skulptura. Ata teksturën e fitojnë duke lënë gjurmë në material, me gërvishtje dhe thellëzim të argjilës, gurit, drurit apo metalit.



Huskoviq: **Prizor**, vaj në pëlhurë (teksturë)



Ordan Petlevski: **Djegje**, Vaj në pëlhurë (teksturë)



Vasil Vasilev: **Ana**, dru (teksturë në skulpturë)

TË MBAJMË NË MEND:

Tekstura është shprehje e ndonjë sipërfaqeje në material në veprën figurative. Kemi tekstura me prejardhje natyrore dhe artificiale, dhe tekstura në veprat figurative.

ELEMENTENTE FIGURATIVE

22

KAHJA

Kahja është element figurativ si pjesë e gjuhës figurative. Në artin figurativ ekzistojnë forma të cilat ndikojnë në syrin tonë sikur të lëvizë në kahje të caktuar. Forma të caktuara kanë *forcë vizuale* të cilat e lëvizin syrin në kahje të caktuara. Kahja e lëvizjes varet nga pamja e formës ose pozitës së më shumë formave së bashku. P.sh. kur kemi prezantuar një dru, syri ynë lëviz lart-poshtë, do të thotë vertikalisht. Nëse kemi prezantuar një radhë drunj, atëherë syri jonë do të lëvizë majtas-djathtas, respektivisht horizontalisht.


Si do të shikojmë varet nga ajo se si artisti i ka vendosur vijat dhe sipërfaqet në vepër. Dallojmë kahje horizontale, vertikale dhe të pjerrët, si dhe vepra pa kahje.

Zhan Dibife: **Vri vrlina**, vaj në pëlthurë (pa kahje)

Kahje vertikale



Kahje Horizontale



Pa kahje



Kahje Vertikale



Kahje e pjerrët

Kahje horizontale kemi kur vijat dhe sipërfaqet e veprës e kahëzojnë syrin të shikojë majtas-djathtas, respektivisht horizontalisht. Në disa vepra syri ynë lëviz lart-poshtë, respektivisht vertikalisht. Në këtë rast, vërtetohemi se kemi kahje vertikale.

Nëse syri ynë në ndonjë vepër apo formë lëviz pjerrët, themi se kemi kahje të pjerrët.

Në ndonjë formë, syri është i qetë dhe nuk lëviz, në këtë rast themi se ajo formë është pa kahje. Pa kahje mund të jetë e gjithë vepra nëse vijat dhe format janë të vendosura në atë mënyrë që forca vizuale nuk e lëviz syrin në asnjë kahje.



Alfred Sisley: **Regata në Hampton**, vaj në pëlhurë (kahje horizontale)



Kahje kontrasti



Edgar Dega: **Vajzë**, vizatim me laps (kahje e pjerrët)



Hundertvaser: **Kopshti**, vaj në pëlhurë (vepër pa kahje)



Pa kahje

TË MBAJMË MEND:

Kahja është forcë vizuale e cila e lëviz syrin në kahje të caktuar në veprën figurative. Dallojmë kahje horizontale, vertikale dhe të pjerrët. Ekzistojnë forma dhe vepra pa kahje.

ELEMENTENTE FIGURATIVE

MADHËSIA

Çdo gjë që shohim rreth nesh ka ngjyrë, forma të ndryshme, por edhe madhësi të caktuar. Disa sende janë më të vogla e disa më të mëdha. Gjësendet janë më të vogla dhe më të mëdha varësisht se cili objekt me cilin krahasohet. Biçikleta është më e vogël se vetura e cila është më e madhe, mirëpo vetura është më e vogël se furgoni, mirëpo edhe furgoni është më i vogël se autobusi i cili është më i madh etj. A është diçka më e madhe apo më e vogël varet nga ajo me cilën i krahasojmë.

Të gjitha veprat figurative janë të kombinuara nga madhësi më të mëdha dhe më të vogla të vijave, sipërfaqeve, toneve, sipërfaqeve të ngjyrosura, teksturave, formave dhe vëllimeve.



E vogël



E madhe



Vepër me madhësi të njëjta



Më e madhe



Shum e madhe



Anri Matis: **Lakuriqësi e kaltër IV**,
Punim në letër (madhësi)



Filjo de Freitas: **Ringjallje 1962**
(proporcion)




Ianeli Arkanxhelo: **Pa titull**,
kompozim i kaltër
(proporcion)

Artistët në histori janë munduar të gjejnë kombinim ideal të madhësive, atë që e pikturojnë ose skulpturojnë të jetë më e bukur. Marrëdhënien mes madhësive të ndryshme e quajmë *proporcion*.

Proporcionet janë shumë të rëndësishme gjatë paraqitjes së njeriut dhe trupit të tij, poashtu edhe në arkitekturë.

Proporcionet janë të rëndësishme edhe në përsëritjen e madhësive, respektivisht ritmi. Nëse përsërisim një element, atëherë vepra duket monotone, përderisa përsërisim elemente të ndryshme, vepra duket më interesante dhe më e bukur për shikim.



Levit Sol: **Kombinime të fuqishme me vija të drejta dhe katër kahje**

TË MBAJMË MEND:

Madhësia është shprehje relative dhe do të thotë kombinim i madhësive të ndryshme në një vepër. Lidhjen e ndërsjellë të madhësive e quajmë proporcion

ELEMENTENTE FIGURATIVE

26

FORMA

E dimë se forma është pamja e jashtme e gjithë asaj që na rrethon, si dhe asaj që prezantohet në artin figurativ.

Të përkujtohemi se kemi forma *dydimensionale dhe tredimensionale*. Me format dydimensionale artistët vizatojnë, pikturojnë dhe bëjnë grafika, kurse me format tredimensionale skulptorët i formojnë veprat e tyre artistike.

Forma mund të jetë e hapur, mbyllur ose e perforuar. Forma e hapur është kur hapësira që e rrethon mund të hyjë mbrendësinë (gotë, vazo, shishe, kapelë).




Formë dydimensionale



Forma dinamike




Vencislav Rihter: H-1, aluminium (formë e perforuar)


Forma Sigatike
(krijim kompjuterik)



Formë e perforuar



Forma statike



Forma dinamike

Format në syrin e njeriut ndikojnë në mënyrë *statike dhe dinamike*, respektivisht kur i shohim format statike ndikojnë qetë dhe nuk e lëvizin shikimin në ndonjë kahje.

Format dinamike në vete përmbajnë forcë vizuale e cila e lëviz syrin në kahje të caktuar, respektivisht format nuk janë statike.

Forma tredimensionale e cila përfshin një pjesë të hapësirës quhet *vëllim*. Skulptorët veprat e veta i realizojnë me vëllim të punuara prej materialeve të ndryshme. Vëllimi mund të jetë *këndor dhe cilindrik, i theksuar dhe i thelluar*



Jordan Grabulovski: **shenja hapësinore**, çimento (formë tredimensionale)

TË MBAJMË MEND:

Forma është pamja e jashtme e gjithë asaj që na rrethon. Kemi forma dydimensionale dhe tredimensionale. Format mund të jenë: të hapura, të mbyllura dhe të perforuara. Dallojmë edhe forma statike dhe dinamike.

ELEMENTENTE FIGURATIVE

HAPËSIRA

E gjithë ajo që na rrethon rreth nesh quhet *hapësirë*. Në hapësirë lëvizim, punojmë dhe argëtohemi. Rruga, shkolla, banesa, dhoma, qyteti, qielli, kozmosi, fshati, fusha... e gjithë kjo është hapësirë. Këtë hapësirë e quajmë hapësirë reale sepse ekziston dhe ne lëvizim në të.


Artistët në veprat e tyre mundohen ta paraqesin hapësirën nga e kaluara e lashtë deri më sot. Paraqitja e hapësirës në veprat artistike quhet *iluzion i hapësirës*.

Iluzioni i hapësirës mund të fitohet me ngjyra të ndritshme dhe të errëta. Ngjyrat e ndritshme saherë duken më larg, kurse të errëtat më afër.

Iluzioni i hapësirës mund të paraqitet edhe me forma më të mëdha dhe më të vogla. Format e mëdha duken më afër, ndërsa të voglat më larg.

Paraqitja më e realtë e hapësirës artistët e kanë arritur me përdorimin e *perspektivës*.


Perspektiva paraqet hapësirën ashtu siç syri jonë e sheh në realitet.




Hapësirë e hapur reale



Qytet, hapësirë e hapur, fotografi

Kamij Pisaro: **Bulevardo Monmartër në mbrëmje**, vaj në pëlhurë (iluzion i hapësirës së jashtme)

Natyrë, hapësirë e jashtme reale, fotografi



Hapësirë e mbyllur e brendshme, fotografi



Perspektivë me horizont dhe një pikë të pamjes



Perspektivë




Alfred Sisley: **Rrugë**, vaj në pëlthurë (perspektivë)

P.sh.: nëse ndalemi në mes të hekurudhës ose rrugës, në lartësi të syve tonë kemi vijë të pamurit në të cilën bashkohet vija e horizontit, respektivisht toka me qiellin.

Në atë vijë, respektivisht horizonti ka pikë të pamjes në të cilën bashkohet e gjithë ajo që shohim, paraqiten vijat që duken më të ngushta dhe më të ngushta, edhe pse nuk janë në realitet. Në atë pikë bashkohen edhe shtyllat e vijave.

Gjatë përdorimit të perspektivës kemi një pikë të pamjes, por mund të kemi dy pika të pamjes majtas dhe djathtas. Me perspektivë mund të paraqitet e gjithë ajo që e shohim në hapësirën e jashtme dhe të brendshme, rrugë me ndërtesa, objekte, automjete dhe njerëz, dhe brendinë e hapësirës me gjithë subjektet.

Perspektivën e përdorin artistë, por më së shumti arkitektët në projektet e tyre.



Perspektivë me horizont dhe dy pika të pamjes



Skicë arkitektonike me perspektivë

TË MBAJMË MEND:

Hapësirë është e gjithë ajo që na rrethon, dallojmë hapësirë reale dhe iluzion në hapësirë. Hapësira paraqitet me ngjyra të ndritshme dhe të errëta dhe me forma më të mëdha dhe më të vogla. Paraqitja më reale arrihet me perspektivë.

ELEMENTENTE FIGURATIVE

30

KONTRAST

Kontrasti është parim figurativ i cili mund të aplikohet me të gjitha elementet figurative. Kontrast do të thotë kundërshtim i vlerave të ndryshme në një vepër. Kontrasti mund të jetë me intensitet më të fortë dhe më të dobët.

Tonet që lëvizin prej të zezës deri te e bardha në veprat figurative mund të kombinohen në kompozim të kontrastit.

Kontrasti mund të fitohet me përdorimin e vijës, nëse në një vepër përdoren vija të drejta dhe të pjerrëta, të trasha dhe të holla, të shkurtra dhe të gjata.

Shpeshherë kontrasti aplikohet me përdorimin e ngjyrave të errëta dhe të ndritshme në një vepër. E ndritshmja dhe e errëta bëjnë kontrast të madh. Kontrasti mund të vërehet edhe mes ngjyrave primare dhe sekondare.




Kontrast i vijës


Ordan Petlevski: **Vizatim**, tush, pendë (kontrast i vijës)

Kontrast i madhësisë dhe ngjyrës (vepër e nxënësit)

Dimitar Kiçevski-Miço:
Ciklus Feniks, vaj në pëlhurë
(kontrast i kahjes)Andrijana Pulemi: **Pikturë**, vaj në pëlhurë (kontrast i ngjyrave të ngrohta dhe të ftohta)



Kontrast i ngjyrave të ndritshme dhe të errëta



Marija Kostojčinovska: **Erik**, vaj në pëlhurë (kontrast ndritshëm-errët)

Shumë vepra figurative efektive janë krijuar me aplikimin e kontrastit *komplementar*. Me këtë kontrast fitohen ngjyra interesante në veprën figurative. Me këtë kontrast forcohet intensiteti i ndërsjellë i ngjyrave.

Madhësi të mëdha dhe të vogla të vijës, sipërfaqes ose forma të tjera shumë shpesh kombinohen në kontrast në një vepër.

TË MBAJMË MEND:

Kontrast është përdorimi i vlerave të kundërta në një vepër figurative. Kontrasti fitohet me të gjitha elementet figurative.



Nikolla Martinovski: **Nëna me fëmijë**, vaj në pëlhurë (kontrast i ngjyrave të ngrohta dhe të ftohta)



Miroslav Masin: **Puthje**, vaj në pëlhurë (kontrast i madhësisë dhe ngjyrës)

ELEMENTENTE FIGURATIVE

32

RITËM

Ritmi ose përsëritja është parim figurativ, i cili aplikohet në disa vepra figurative.

Ritëm është kur ndonjë element figurativ përsëritet njëpasnjëshëm më shumë herë në një vepër.

Përsëritja shpeshherë është prezente tek punimet e dorës nga historia, në dezen, poashtu edhe në arkitekturë.




Qëndisje popullore maqedonase (ritëm i formës dhe ngjyrës)



Përsëritje në arkitekturë



Përsëritje në arkitekturë




Përsëritje në natyrë




Ornament
(ritëm i formës dhe ngjyrës)



Dezen (ritëm i formës dhe ngjyrës)




Ritëm rregullar



Ritëm alternativ
(vepër kompjuterike)



Ritëm alternativ



Tome Mishev: **Dijalog**, vaj në pëlhurë (ritëm i lirë)

Dallojmë dy lloje të ritmit, *rregullar dhe alternativ*. Ritëm rregullar është kur një element i njëjtë nuk ndryshohet gjatë përsëritjes. Do të thotë ai përsëritet më shumë herë. Përsëritja mund të jetë horizontale, vertikale ose në të gjitha drejtimet.

Ritmi alternativ është më interesant nga shkak se tek ai mund të ndryshohen dy ose më tepër elemente me formë të ndryshme, me ngjyrë të ndryshme, ton ose madhësi të ndryshme.



Umberto Boçoni: **Forma të vetme të kontinuitetit të hapësirës**, bronzë (ritëm i lirë)

TË MBAJMË MEND:


Përsëritjen e elementeve figurative një pas një e quajmë ritëm. Dallojmë ritëm rregullar dhe alternativ.

ELEMENTENTE FIGURATIVE


HARMONIA

E dimë se harmonia është parim figurativ me të cilin i kombinojmë elementet figurative në kombinim të ndërsjellë harmonik. Edhe vizatimi edhe piktura, skulptura dhe dizajni e aplikojnë këtë parim që të fitojnë harmoni në vepër.


Harmoni në një vepër figurative mund të arrijmë nëse e krijojmë me vija të ngjashme, ngjyra të ngjashme, tone, tekstura ose elemente tjerë të ngjashme. Kjo harmoni me ngjashmëri quhet *harmoni nga analogjia*.



Harmoni me tone akromatike

Vasko Tashkovski: **Dru bregdetar**,
tush, pendë
(harmoni me vija)Veljo Tashovski: **Hapësirë II**,
teknikë e kombinuar
(harmoni me ton)

Harmoni me ton




Harmoni me vija, forma, tekstura, madhësi dhe ritëm



Pablo Pikaso: **Ëndërr**, vaj në pëlhurë (harmoni me formë)



Stenton Mekdonald Vrajt: **Organizata 5**, vaj në pëlhurë (harmoni me formë)



Ilija Koçvski: **Zonë**, (harmoni me vijë dhe madhësi)

Harmoni arrijmë nëse në një vepër shfrytëzojmë vija të lakuara të ngjashme, të trasha, të holla të gjata apo të shkurtra. Nëse përdorim tone më të ndritshme apo më të errëta të ngjashme ose madhësi të ngjashme. Me ngjyrën mund të arrijmë harmoni nëse përdorim ngjyra të ngjashme në një vepër. Për shembull: të gjelbër, të gjelbër- të kaltër dhe të verdhë; të kuqe, portokalle dhe të verdhë; të kaltër, vjollcë dhe të kuqe etj.



Anri Ruso: **Ëndërr**, vaj në pëlhurë (harmoni me formë dhe ngjyrë)



Rubens Korubin: **Në atelienë time**, akrilik (harmoni me ton)

TË MBAJMË MEND:

Me kombinim të vlerave të ndryshme fitojmë harmoni. Këtë mënyrë e quajmë harmoni të analogjisë.

ELEMENTENTE FIGURATIVE

36

BARASPESHA


Baraspesha është parim dhe pjesë e gjuhës figurative me të cilën u njoftuam më parë, por çdo herë është prezent në shprehjen figurative. Baraspesha është tipar i gjithë nesh dhe asaj që na rrethon. Njeriu synon për baraspeshë mendore dhe fizike, natyra arrin baraspeshë që të mbijetojë. Ky parim është i rëndësishëm në jetën e përditshme për ruajtjen e tërësisë së jetës dhe mbijetimit. Baraspesha në një vepër figurative arrihet me mënyrën e kombinimit të elementeve figurative në një tërësi.



Simetri në natyrë



Pablo Pikaso: Zonjusha nga Avinjon, vaj në pëlhurë (asimetri)




Simetri



Ornament (simetri)



Asimetri



Simetri (punim kompjuterik)

Mënyra e fitimit të baraspeshës arrihet me rregullim nëpërmjet simetrisë apo asimetrisë. Sipas asaj dallojmë baraspeshë simetrike dhe asimetrike.

Të përkujtohem se simetria fitohet kur dy gjysma të veprës, në anën e djathtë dhe të majtë vendosim vlera të njëjta në vend të njëjtë, me radhitje identike.

Në gjuhën figurative parimi i baraspeshës ka për detyrë ta rregullojë atë vlerë në veprën figurative, vizatimin, pikturën, grafikën, skulpturën ose dizajnin.



Dimitar Kondovski: **Pa titull**, vaj në dru (asimetri)



Danço Kalçev: **Piktura 1323**, vaj në dru (asimetri)

TË MBAJMË MEND:

Baraspeshë është kombinim i elementeve figurative në një tërësi në mënyrë simetrike dhe asimetrike.

ELEMENTENTE FIGURATIVE

38

GRADACION


Në gjuhën figurative ekziston parim figurativ i quajtur gradacion. Ky parim na tregon se secili element figurativ mundet të ndryshohet gradualisht prej një vlere në tjetër. Toni mund të ndryshohet prej të ndritshëm në më të errët gradualisht, ngjyra prej në të verdhë ngadalë mund të kalojë në të gjelbër, në të kaltër, pastaj në vjollcë e deri në të kuqe. Gradacion i ngjyrave më së miri mund të shihet tek spektri i ngjyrave.



Teodor Zheriko: **Portret plake**, vaj në pëlhurë
(gradacion me ton)



Gradacion me ngjyrë



Gradacion me ton



Gradacion me vijë dhe kahje



Gradacion me teksturë

GJUHA FIGURATIVE

02

ELEMENTET FIGURATIVE

39



Gradacion me madhësi



Pablo Pikaso: **Grupa që hekuros**, vaj në pëlhurë (gradacion me ton)



Jan Vermer: **Vajzë**, vaj në pëlhurë (gradacion me ton)

Edhe forma mund ta ndryshojë pamjen e vet, me gradacion, kështu që prej trekëndëshit me ndryshim gradual mund të transformohet në rreth.

Në arkitekturë shpeshherë aplikohet parimi i gradacionit me të cilin hapësira gradualisht zvogëlohet



Gradacion me madhësi



Gradacion me formë



M. Kraljeviq: **vajza me çorape të kaltra**, vaj në pëlhurë (gradacion me ton)

TË MBAJMË MEND:


Gradacioni është kalim gradual i elementeve figurative nga një vlerë në tjetër.

PROPORCIONI

Artisti figurativ çdo herë mundohet ta paraqesë bukurinë e subjekteve që na rrethojnë.

Në vizatim, pikturë, grafikë apo skulpturë kombinohen madhësi të ndryshme në një tërësi me qëllim që të arrihet një bukuri ideale. Marrëdhëniet e madhësive në një tërësi quhen proporcioni.


Artistët çdo herë mundohen ta gjejnë proporcionin ideal të trupit të njeriut me të cilin do ta paraqesin bukurinë e njeriut.




Proporcioni i trupit të njeriut




Shtëpi maqedonase (proporcioni)



Instrument (proporcion)




Pit Mondrijan: **Tablo II**, vaj në pëlhurë



Figurë njeriu (proporcion)



Gaudi: **Katedrala në Barcelonë**, (proporcion në arkitekturë)



Vitruvuje: **Skema e njeriut**, vizatim (proporcion)

TË MBAJMË MEND:

Proporcion është marrëdhënia mes dy madhësive në një vepër figurative.

ELEMENTENTE FIGURATIVE

42

UNITETI

Uniteti është parim figurativ i cili është i ngjashëm më harmoninë. Qëllimi i tij është që në veprën figurative t'i bashkojë të gjitha pjesët në një tërësi.

Ky parim arrihet me përdorimin e vijave, teksturave, toneve, ngjyrës formave, madhësive, vëllimit, kahjes ose hapësirës së njëjtë ose të ngjashme.



Bashkësi me ngjyrë

Mihal Larinov: **Pikturë**, vaj në pëlhurë (unitet me vlera të ngjashme)Dushan Xhamonja: **Skulpturë metali 3**, (unitet me teksturë)Amadeo Modigliani: **Madam Pampadur**, vaj në pëlhurë (bashkësi me ngjyrë)Petar Lubarda: **Beteja e Kosovës**, vaj në pëlhurë (bashkësi me formë dhe ngjyrë)



Anri Matis: **Shpërthim i gjetheve, gvash** (bashkësi me forma dhe madhësi)



Jan Arp: **Mal, çengel, kërthizë**, vaj në pëlhurë (bashkësi me formë)



Bashkësi me formë



Pol Gogen: **Natyrë e vdekur**, vaj në pëlhurë (bashkësi me ton dhe ngjyrë)



Klod Mone: **Peizazh**, vaj në pëlhurë (bashkësi me ngjyrë)

TË MBAJMË MEND:

Me përdorimin e vlerave të ngjashme të elementeve figurative, arrihet bashkësi në veprën figurative.

ELEMENTENTE FIGURATIVE

44

KOMPOZIMI

Në kompozim, si parim figurativ, artisti mundohet figurativisht t'i radhisë elementet në një tërësi artistike. Në kompozimin radhiten vijat, ngjyrat, tonet, format, vëllimi, tekstura me qëllim që të fitohet tërësi e cila ka vlerë artistike.

Njëjtë sikurse tek artet tjera, kompozimi mundohet që të bëjë radhitjen e fjalëve në një tekst artistik, në muzikë kompozitori i radhit, respektivisht i komponon notat në melodi të cilën dëgjuesi me kënaqësi e dëgjon dhe kënaqet në bukurinë e saj.



Jezusi, ikonë,
Ohër (kompozim vertikal)



Vasil Vasilev: **Forma Vertikale asociative 5**, dru (kompozim vertikal)



Afrim Spahiu: **Peizazh**, fotografi (kompozim horizontal)



Zhan Person: **Më fal**, vaj në pëlhurë (kompozim horizontal)



El Greko: **Portret i Sh. Andrea**, vaj në pëlhurë (kompozim diagonal)



Fernand Lezhe: **Zhytës polihrom**, vaj në pëlhurë (kompozim i mbyllur)

Kompozimi fitohet me radhitjen e ngjyrave, primare, sekondare, të ftohta dhe të ngrohta, toneve, vijave dhe vlerave tjera figurative.

Kompozimi në veprën figurative mund të jetë horizontal, vertikal dhe diagonal, varësisht se si lëviz syri ynë gjatë vështrimit të veprës figurative.

Nëse kompozimi është i gjatë horizontalisht dhe në të radhiten në ritëm më tepër forma dhe madhësi, atë e quajmë *friz*.



Hans Sebalt: **Adam dhe Eva**, shkrim në bakër (kompozim vertikal)



Konstantin Kaçev: **Lihnida**, vaj në pëlhurë (kompozim vertikal)



Lj. Njersh: **Torzo**, vaj në pëlhurë (kompozim vertikal)



Amadeo Modiljani: **Akt me qafore**, vaj në pëlhurë (kompozim diagonal)



kompozim i hapur



Gjueti e gjedhëve, friz, Bagdad (kompozim horizontal)

TË MBAJMË MEND:

Kompozim është radhitja e elementeve figurative në një tërësi. Dallojmë kompozim horizontal, vertikal dhe diagonal.

Me motiv në artin figurativ u njoftuam në klasën e kaluar. Pamë se arti figurativ i plotëson nevojat shpirtërore të njeriut. Ndjejmë kënaqësi, dhe bukuria kur vështojmë një vizatim, portret, skulpturë apo grafikë.

Përmbajtja e veprës figurative mund të njihet, respektivisht në të mund të dallojmë ndonjë fytyrë, send apo ngjarje, por mund të jetë edhe vepër e vijave të bukura të kombinuara. Ngjyra, tone, hapësira, vëllime në të cilat syri ynë edhe ne kënaqemi dhe pushojmë.


Nëse në veprat figurative dallojmë fytyrë njeriu, send, pjesë të natyrës ose diçka tjetër, themi se ajo vepër ka *motiv*. Motivi mund të jetë *portret, autportret, karikaturë, figurë, akt, kafshë, enterier, peizazh ose natyrë e vdekur*.

Nëse në veprën figurative kemi vetëm kombinim të vijave, ngjyrave, toneve, vëllimit, formave etj, atëherë themi se ajo është vepër pa motiv, respektivisht vepër *abstrakte*.

Kur në veprën figurative është prezantuar fytyrë e njeriut, atë motiv e quajmë *portret*.



Leonardo da Vinci: **Mona Liza**, vaj në pëlhurë (me motiv)



Mark Rothko: **Bardh e gjelbër në të kaltër**, vaj në pëlhurë (abstrakte)



Endi Vorhol: **Portret i Mik Xheger**, grafikë

PORTRET

Artistët shpeshherë nëpër histori dhe sot kanë paraqitur portrete të njerëzve, sundues, njerëz me merita të mëdha ose njerëz të thjeshtë me profesione të ndryshme.

Artistët në përgatitjen e portretit mundohen ta paraqesin dukjen fizike të njeriut, por njëkohësisht mundohen t'i paraqesin edhe karakteristikat e tyre shpirtërore dhe pamjen e fytyrës.

AUTOPORTRET

Autoportret është kur autori e paraqet fytyrën e vet në vepër figurative. Kemi vepra në të cilat paraqitet vetëm fytyra e autorit, por shumë shpesh në histori piktori kur pikturon skena grupore me shumë fytyra në ndonjë ngjarje, në ndonjë fytyrë të grupit e pikturon autoportretin e tij. Kjo ndodh në skena me ngjarje historike apo mitologjike.



Endi Vorhol: **Portret i Ingrid Bergman**, sito-shtyp



Blagoja Nikolovski: **Portret plake**, vaj në pëlhurë



Ogist Renoar: **Portret i Viktor Çoku**, vaj në pëlhurë



Pol Sezan: **Autoportret**, vaj në pëlhurë

Kamij Pisaro: **Autoportret**, vaj në pëlhurë



Miroslav Kraçeviq: **Autoportret me qen**, vaj në pëlhurë



Antoan Vato: **Autoportret**, vaj në pëlhurë



KARIKATURA

Karikatura është motiv specifik në të cilin artisti e potencon karakteristikën psikologjike të njeriut, karakteristikat e tij të përditshme, të jashtëzakonshme ose jonjerëzore qesharake, respektivisht karakteristikat negative tek njerëzit.



Onore Domie: **Konte**, bronz



Onore Domie: **Karikaturë**, litografi



Onore Domie: **I sëmurë mendjemadh**, litografi



Onore Domie: **Krispen dhe Skapen**, vaj në pëlthurë

FIGURA

Vetë emri i motivit na sqaron se veprat në të cilat është prezent ky motiv paraqesin *figura* të njerëzve.

Ky motiv është shumë i rëndësishëm për ne për shkak se na paraqet njeriun dhe veshjen e tij karakteristike nëpër histori sepse në këtë periudhë nuk ka ekzistuar fotografia si dokument.

Nëpërmjet këtij motivi mësojmë si kanë qenë të veshur njerëzit në kohët e lashta, në Egjipt, Romë, Greqi, në periudha të ndryshme historike, dhe në to dallojmë sundues, ushtarë, priftërinj, zejtarë, profesione të ndryshme dhe njerëz të thjeshtë.



Onore Domie: **Avokat**, tush i dredhur

AKT

Nëse në një vepër figurative shohim trup lakuriq të mashkullit apo të femrës, themi se ai motiv është *akt*.

Akti ka qenë motiv i artistit prej historisë së lashtë e deri më sot.

Nëpërmjet këtij motivi artisti na paraqet bukurinë dhe harmoninë e trupit të njeriut pa rroba. Shumë artistë në krijimtarinë e tyre kanë krijuar vepra me këtë motiv



Ogist Renoar: **Në shëtitje**, vaj në pëlhurë



Angeliko: **Sv. Katerina**, tempera



Amadeo Modiljani: **Grua lakuriq**, vaj në pëlhurë

Pol Gogen: **Tahineze**, vaj në pëlhurë



Konstantin Kaçev: **Lihnida**, vaj në pëlhurë



Ogist Roden: **Puthje**, mermer



Ivan Meshteroviq: **Përkujtim**, mermer

ZHANËR


Artistët vizatojnë dhe pikturojnë atë që e ndjejnë, shohin, respektivisht atë që i rrethon në jetë. Shpeshherë në veprat e tyre paraqesin skena të jetës së përditshme, njerëz, tubime, zakone, ndodhi të ndryshme. Këtë motiv e quajmë *zhanër-skena*.

Nëpërmjet këtyre veprave në të cilat janë paraqitur zhanër-skena, ne, njerëzit e sotshëm, njihemi me jetën e njerëzve nëpër histori.

Mësojmë se si janë veçur, si kanë jetuar, çfarë veglash kanë përdorur, si është dukur rrethina e tyre, vendbanimet etj. Edhe ky motiv është dokument për kohën në të cilën kanë qenë të krijuara veprat.



Diego Velasquez: **Farkëtari**, vaj në pëlhurë



Edgar Dega: **Gotë pelinkovec**, vaj në pëlhurë



Jan Vermeer: **Pijaniste**, vaj në pëlhurë



Eduard Mone: **Kafjall në barë**, vaj në pëlhurë

KAFSHË

Shtazët çdo herë kanë qenë pjesë e jetës së njeriut, si kafshët shtëpiake apo ato në natyrë. Disa prej tyre i kanë ndihmuar të mbijetojnë, të ushqehet, e disa me bukurinë e tyre i ka shfrytëzuar për dëfrim.

Në histori disa civilizime dhe popuj e kanë marrë figurën e ndonjë kafshe si simbol i tyre të bukurisë apo të fuqisë, siç është figura e kalit, demit, luanit, shqiponjës etj.

Edhe artistët figurativ në veprat e veta kanë paraqitur kafshët duke dashur ta paraqesin bukurinë dhe fuqinë e tyre. Paraqitja e kafshëve si motiv quhet *animalizëm*.



Vizatim parahistorik prej



Enë e kuqe në formë gjedhi,
terakota, Teheran



Leonardo da Vinçi: **Studim i kalit**,
vizatim



Relief



Pablo Pikaso: **Dhia**, bronzë

ENTERIER

Enterieri është motiv kur artisti e paraqet brendinë e shtëpisë ose hapësira tjera në të cilat banon ose punon. Sikurse motivet tjera, edhe ky motiv është dokument për kohën në të cilën është krijuar vepra.



Tuluz Lotrek: **Lojtar i zi në bar**,
vizatim



Vermer: **Dhoma**, vaj në pëlthurë



Velaskez: **Zonjat e vogla të oborrit**, vaj në pëlthurë



Vinsent van Gog: **Kafene e natës**, vaj në pëlthurë

PEIZAZH


Të gjithë ne kemi dëshirë të dalim në natyrë dhe të kënaqemi me bukuritë e saj. Edhe artistët figurativ duke i paraqitur bukuritë e maleve, pyjeve, liqeneve, fushave, lumenjve, qiellit, fshatrave dhe qyteteve na e përcjellin atë bucuri në shtëpitë tona, galeri apo në vendin ku lëvizim. Ky motiv quhet *peizazh*.



Vasko Tashkovski: **Plazhi i dinozaurëve**, vaj në pëlhurë




Adem Kastrati: **Peizazh dimri**, vaj në pëlhurë



Piter Brojgel: **Gjatar të borës**, vaj në pëlhurë



Pol Sezan: **Gjiri Lestenja**, vaj në pëlhurë



Rubens Korubin: **Kopsht**, akril

Nikola Martinovski: **Peizazh nga Zapreshiq**, vaj në pëlhurë



NATYRË E VDEKUR

Artisti i vëren të gjitha subjektet rreth tij dhe i zgjedh si përmbajtje për veprat e veta. Nëse në vepër shohim subjekte të ndryshme, bimë, ose kafshë të vdekura, themi se në vepër si motiv është paraqitur *natyrë e vdekur*.



Danço Kalçev: **Natyrë e vdekur**, vaj në pëlhurë




Eduard Mone: **Lule**, Vaj në pëlhurë



Pablo Pikaso: **Natyrë e gjelbër e vdekur**, vaj në pëlhurë



Eugen Delakroa: **Natyrë e vdekur**, vaj në pëlhurë



Dragan Najdenovski: **Natyrë e vdekur**, vaj në pëlhurë



Pol Sezan: **Natyrë e vdekur**, vaj në pëlhurë

ARTI FIGURATIV

54

Në klasën e kaluar u njohëm me artin figurativ dhe me fushat figurative. Tani më e dimë se kemi vizatim, pikturim, skulpturë, grafikë dhe komunikime vizuale dhe dizajn. Nëse artisti shfrytëzon ndonjë material me të cilin nëpërmjet vijës, teksturës ose formave tjera shprehet me vizatim, themi se ajo vepër i përket fushës së vizatimit.

Në fushën figurative të vizatimit, artisti bën piktura në të cilat shprehet me ngjyra dhe sipërfaqe të ngjyrosura. Kjo sferë çdo herë ka qenë më prezente në artin figurativ.

Në raste kur vepra figurative punohet me ndihmën e shtypjes, me të cilën fitohen disa vepra të njëjta figurative, themi se ajo fushë është grafika.



Rubens Korubin: **Peizazh nën hënë**, akril

Kolio Karanfilov: **Kokë e kuqe**, terakota



Vizatim



Rembrant: **Gërsheta**, Tush i dredhur



Klod Mone: **Katedrale në Ruen**, detal






Dizajn i revistës



Vizatim, tush, thëngjill




Qeramikë, terakota



Dizajn i stolisë



funeral Mbretëror, friz, relief, mermer



Dizajn i enterierit

TË MBAJMË MEND:

Arti figurativ ndahet në këto fusha figurative: vizatim, pikturim, skulpturë, grafikë dhe komunikim vizual dhe dizajn

Për dallim nga vizatimi, piktura ose grafika, artistët skulptorë punojnë vepra në hapësirë. Ato janë skulptura ose reliefë të krijuara nga materiale të ndryshme siç janë: guri, metali, druri ose plastika.

Përveç artistëve që krijojnë vepra artistike, ekzistojnë edhe artistë të cilët i quajmë dizajnerë. Ata janë artistë të cilët e krijojnë pamjen e subjekteve për përdorim të përditshëm. Këta artistë e zbukurojnë përditshmërinë tonë dhe subjektet që i përdorim.

Dizajnerët shpikin pamjen e kopertinave dhe ilustrimet e librave të cilat i lexojmë, gazetatat dhe revistat, pllakatet, reklamat, bilbordet, ambalazhet e prodhimeve që i blejmë në shitore, veshmbathjen, lodrat, aparatet e amvisërisë, mobilet, automjetet dhe gjithë atë që e shohim rreth nesh.

FUSHA FIGURATIVE

56

Sikurse në klasën e kaluar, po ashtu edhe në këtë klasë do të vizatojmë, e njëkohësisht do ta zhvillojmë shprehjen tonë figurative nëpërmjet vizatimit.

Vizatimi është vepër figurative me të cilën janë shprehur dhe shprehen artistët figurativ pa marr parasysh se a janë piktorë, artist grafikë, skulptorë apo dizajnerë.

Në art vizatimi shërben si fillim i krijimit të veprës së re figurative, shënimi i idesë fillestare dhe përpunimi i saj si duhet të duket.

Shënimi i idesë fillestare bëhet me skicë ose kroki-vizatim. Skica është vizatim i shpejtë i asaj që e shohim ose ndonjë ideje të cilën e kemi menduar momentalisht. Skica bëhet me lëvizje të shpejta dhe të thjeshta pa i shprehur detajet.

Për dallim nga skica, me vizatim bëhen *studime* të asaj që është në pikturë, modelohet ose dizajnohet.

Studimi në artin figurativ është vepër në të cilën artisti në detaje i paraqet subjektet.

Ajo bëhet kohë më të gjatë dhe kushtohet vëmendje e posaçme.

E dimë se mund të vizatohet me secilin material i cili në letër lë gjurmë.



Rembrandt: **Skicë për pikturë**, vizatim



Danço Ordev: **Akt**, kroki, tush, dru



Edgar Dega: **Balerina**, vizatim



Dushan Xhamonja: **Skicë për përmendore**, tush, pendë



Leonardo da Vinçi: **Studim për darkën e fundit**, vizatim



Dushan Xhamonja: **Skicë për skulpturë**, tush, pendë



Skicë e shpejtë e njeriut



Edgar Dega: **Vizatim, Thëngjill**



Vasko Tashkovski: **Dru në periferi**, tush, pendë



Studim me laps

TË MBAJMË MEND:

Në vizatim shprehemi figurativisht me vizatim. Skica është vizatim i shpejtë, studimi është vizatim detajor.

TEKSTURA

Në artin figurativ vizatohet e gjithë ajo që mund të shihet rreth nesh dhe gjithë ajo që mund të paramendohet në fantazmën tonë. Gjithë ajo që e shohim dhe paramendojmë e paraqesim me vija. Sikurse në natyrë, ashtu edhe në vizatim secila formë ka sipërfaqen e vet karakteristike. Sipërfaqet nuk janë të njëjta, ndonjëra është e vrazhdë, ndonjëra e lëmuar, e ashpër apo dijshme. E dimë se paraqitja e karakterit të sipërfaqeve të paraqitura me vizatim e quajmë *teksturë*.

Teksturën në vizatim e paraqesim me vija të ndryshme, por mundet edhe me pika. Nëse përdorim pika, duhet të shpikim lloje të ndryshme, të mëdha, të vogla, në kombinime të ndryshme, të vendosura më shpesh ose më rrallë. E njëjta vlen edhe për vijat të cilat duhet të jenë të ndryshme, të trasha, të holla, të gjata, të lakuara dhe të drejta, dhe të vendosura në kombinime të ndryshme.


Nëse në vizatimin tonë mundemi t'i dallojmë format e vizatuara sipas shumëllojshmërisë së teksturës, ne kemi arritur ta paraqesim materialin e vizatimit.



Ordan Petleski: **Plasje**, tush (teksturë)



Kamij Pisaro: **Panairi i derrave**, tush dhe pendë (teksturë me pika)



Teksturë me vijë dhe pika



Teksturë me vijë



Vinsent van Gog: **Peizazh**, tush, pendë (teksturë)



Teksturë

TË MBAJMË MEND:

Teksturën në vizatim e fitojmë me përdorimin e vijave të ndryshme dhe kombinim të pikave.

FORMA




Vizatim, laps



Amadeo Modigliani: Njeriu me mjekër, tush



Skicë, vizatim, tush



Forma statike



Forma dinamike

TË MBAJMË MEND:

Format në vizatim mund të duken statike dhe dinamike.

Në gjuhën figurative u njoftuam me formën si element figurativ. E gjithë ajo që duam ta vizatojmë ka formë, e ajo është fytyra e asaj që e paramendojmë. Në vizatim shprehemi me forma dydimensionale të cilat i paraqesim me vijë.

Kur vështrojmë një vizatim, ai mund të duket i qetë apo jo i qetë, varësisht nga ajo se me çfarë vija dhe forma është vizatuar. Secila formë në vete përmban forcë vizuale e cila e lëviz syrin në kahje të caktuar me të cilën disa forma duken të qeta, respektivisht themi se janë *statike*. Ato forma të cilat duken jo të qeta i quajmë *dinamike*.

Nëse në vizatim shfrytëzojmë më tepër forma statike, vizatimi do të duket i qetë, por nëse përdorim më tepër forma dinamike vizatimi do të duket jo i qetë, respektivisht dinamik. Cilat dhe çfarë forma do të shfrytëzojmë varet nga ne, nga karakteri ynë dhe prej personalitetit tonë.

HAPËSIRA

E dimë se në artin figurativ paraqesim iluzion në hapësirë, respektivisht hapësirën reale që na rrethon e paraqesim me vijë, ngjyrë, ton ose me ndonjë tjetër element figurativ.

Në vizatim është me rëndësi të fitojmë iluzion prej së afërmi dhe prej së largu. Nëse vizatojmë forma më të vogla dhe më të mëdha, me të voglat duken sikur të jenë më larg, ndërsa të mëdhatë më afër. Për shembull, figurë më e madhe dhe më e vogël e njeriut, në vizatim figura më e vogël duket sikur të jetë më larg dhe anasjelltas.

Në vizatim shpeshherë përdorim hapësirë me ndihmën e *perspektivës*.

Në perspektivë kemi horizont, respektivisht vijë të pamurit dhe pikë të pamurit në të cilën bashkohen të gjitha vijat e asaj që e shohim. Për shembull, nëse ndalemi në mes të rrugës të gjitha vijat paralele rreth nesh, trotuaret, ndërtesat, drurët lëvizin nga horizonti, zvogëlohen dhe bashkohen me pikën e të pamurit. Këtë mund ta shohim në shembujt në këtë libër.




Perspektivë me horizont dhe dy pika të pamurit



Hapësirë reale e madhe-vogël



Perspektivë, vizatim



Perspektivë me pikë të pamurit

TË MBAJMË MEND:

Iluzioni në hapësirë paraqitet edhe në vizatim me ndihmën e formave të mëdha dhe të vogla me perspektivë

KONTRAST



Kontrast i vijës

Elementi figurativ kontrast shpeshherë është prezent në vizatim. Kontrast fitojmë me shfrytëzimin e intensitetit të ndryshëm të vijave, më të trasha më të holla, të gjata dhe të shkurta, të drejta dhe të lakuara. Me shumëllojshmërinë e intensitetit të vijës fitojmë vizatim me pasuri të vijave të shumëllojshme.



Kontrast i vijës (vepër e fëmijëve)



Kontrast i vijës



Vinsent van Gog: **Shtëpi e verdhë**, tush, pendë (kontrast i vijës dhe teksturë)



Edvard Munk: **Bërtitje**, tush (vijë kontrast)


TË MBAJMË MEND:

Me shfrytëzimin e vijave të ndryshme fitojmë kontrast në vizatim.

KOMPOZIMI

Me vetëdije apo pa vetëdije, secili që vizaton bën kompozim të hapësirës në të cilën vizaton. Ne i radhim format dhe vijat në një radhë për të cilën mendojmë se është më e mira me të cilën e ndërtojmë kompozimin sipas dëshirës dhe mendimit tonë.

Kompozim bëjmë prej figurave të lira apo gjeometrike, vijave, pikave, teksturave. Kur vizatojmë natyrë të vdekur me pemë apo fryte tjera ne i kompozojmë ashtu që vizatimi të jetë me kompozim të bukur, do të thotë nuk i vendosim rastësisht nëpër gjithë hapësirën pa qëllim apo pa ndjenjë.



Vizatim, laps



Natyrë e vdekur, pastel



Natyrë e vdekur, pastel



Vizatim, pastel



Natyrë e vdekur, laps



Natyrë e vdekur, laps

TË MBAJMË MEND:

Edhe në vizatim formojmë kompozim interesant të elementeve figurative sipas dëshirës dhe mendimit tonë.

TUSH



Vasko Tashkovski: **Shtëpi në Shkupin e vjetër**, tush, dru



Anri Matis: **Akt në studio**, tush, pendë



Si nxënës, më së shpeshti vizatojmë me tush të zi, mirëpo mund të punojmë edhe me tush me ngjyrë. Ekzistojnë tush për vizatim me ngjyra shumë interesante. Me to mund të vizatojmë me pendë metalike me majë të mprehtë, me dru ose me brushë e cila ka majë. Tushi me ngjyrë është interesant sepse na mundëson të bëjmë vizatim të begatshëm me vija dhe sipërfaqe të shumëllojshme, të ngjyrosur me ngjyra të ndryshme.

Me tush me ngjyrë vizatohet në të njëjtën mënyrë sikurse me tush të zi. Vizatohet në bazë të lëmuar, por më së miri është letër-hamer. Përveç asaj se mund të vizatojmë, kur ta mbarojmë vizatimin, tushin mund ta përziejmë me ujë dhe të bëjmë vizatim të hijezuar. Do të thotë që format që i kemi vizatuar mundemi t'i kalojmë me brushë sikurse pikturojmë, me ngjyra të ndryshme apo me një ngjyrë, me tone më të ndritshme apo më të errëta.

Vijat dhe ngjyrat që do t'i përdorim varet nga ideja jonë që e kemi paramenduar si autor.



Bonard: **Gjel**, tush, brushë



Vizatim i hijezuar me tush dhe brushë

Difi: **Instrumentist**, tush, pendë

TË MBAJMË MEND:

Tushi është teknikë e vizatimit. Vizatojmë me pendë, dru ose brushë në anën e lëmuar të letrës. Nëse e përziejmë tushin me ujë fitojmë vizatim të hijezuar.

FUSHA FIGURATIVE

64

Në klasat e kaluara u njoftuam me pikturimin si sferë figurative e artit figurativ. Në këtë fushë, me ngjyra të ndryshme apo me materiale të ngjyrosura krijohet vepra figurative e quajtur pikturë.

Piktura bëhet me ngjyrë. Ngjyra fitohet në mënyrë natyrale dhe artificiale. Gjendja e parë e ngjyrës është në formë pluhuri, të cilin e quajmë pigment. Këtë pigment pastaj e përziejmë me ndonjë materie dhe fitohet akuareli, temperi, ngjyra e yndyrshme, polikolori ose akrili, të cilat janë teknika të lëngshme për pikturim. Nga pigmenti bëhen pasteli, pasteli dyllë, lapsi me ngjyrë etj. Përveç ngjyrave me të cilat drejtpërdrejt pikturojmë, në pikturim kemi edhe teknika me të cilat me materiale të ngjyrosura bëjmë pikturë.


Në këto teknika bëjnë pjesë kolazhi, mozaiku, vitrazhi dhe tapiceria.

Në tapiceri kemi penj me ngjyra të ndryshme, me të cilat endet tapiceria.

Në vitrazh formojmë vepër me qelq të ngjyrosur me ngjyra të ndryshme të cilat mes veti lidhen me plumb. Mozaiku është teknikë në të cilën përdoren gurë të ndryshëm të cilët të bashkuar në një tërësi e formojnë veprën e cila më së shpeshti është e vendosur në mur.




Mozaik i dyshemesë nga bazilika e madhe, Heraklea



Mikica Trujkanović: **Dita jote**, teknikë e kombinuar



Pigment



Përpunim i ngjyrës nga pigmenti



Freska në kishë, Voznesenie Hristovo, Maleshevë



Litiska ikona, Ohër




Petar Mazev: **Kurban**, vaj në pëlhurë



Rada Petrova-Malkiq: **Pa titull**, tapiseri

Për ne më i afërt është kolazhi të cilin e kemi përdorur në pikturim. Në këtë teknikë, me ndihmën e sipërfaqeve të ngjyrosura të letrës, gazetave, revistave apo tekstilit, me prerje në forma të ndryshme, bëjmë vepër piktorale sipas paramendimit tonë. Me ngjyrat e ngurta pikturohet drejtpërdrejt në sipërfaqe kurse ngjyrat e lëngshme vendosen me brushë apo me lopata për pikturim. Ngjyrat e lëngshme duhet të përzihen me materie të cilën e quajmë medium. Medium për akuarel, temperë, gvashtë dhe polikollor është uji ndërsa për ngjyrat e yndyrshme është vaji i lenit dhe terpentina.


Me ndihmën e arsimtarit të artit figurativ do të mësoni se si punohet me brusha dhe me teknikën e pikturimit që të fitoni rezultate më të mira figurative. më së shpeshti pikturohet me një teknikë, por ndonjëherë teknikat kombinohen dhe fitohet vepër figurative me teknikë të kombinuar.



Hunder Vaser: **Qytetar**, teknikë e kombinuar



Gitara, akuarel



Mikica Trujkanoviq: **Parodija Viktori**, teknikë e kombinuar

TË MBAJMË MEND:

Pikturimi është fushë e artit figurativ. Pigmenti është ngjyrë pluhur. Teknika të pikturimit janë: akuarel, temper, ngjyra të yndyrshme, polikollor, akril, pastel, pastel me dyllë, mozaik, vitrazh dhe tapiseri.




NGJYRA

Në përmbajtjet e kaluara e pamë se pa ngjyrë njeriu nuk mund ta paramendojë jetën e vet. Po ashtu edhe pikturimi nuk mund të paramendohet pa përdorimin e ngjyrave kromatike ose akromatike, primare ose sekondare, të ngrohta apo të ftohta, kontraste apo harmonike.

E gjithë ajo që na rrethon dhe e gjithë ajo që do ta zgjedhim që të paraqitet në veprat tona posedon ngjyrë. Disa subjekte, dukuri ose sende tjera janë të ngjyrosura me ngjyra të ndryshme, por disa çdo herë i shikojmë me ngjyrë të njëjtë. Për shembull: qiellin sa herë e paramendojmë të kaltër, barin dhe gjethet të gjelbër, bananen ose limonin të ngjyrosur me të verdhë, portokallin ngjyrosur me ngjyrë portokalli, domaten me ngjyrë të kuqe, shalqirin dhe lakrën të gjelbër etj.

Për të gjitha sendet që dimë se janë të ngjyrosura me ndonjë ngjyrë të caktuar themi se kanë ngjyrë lokale. Sipas kësaj mund të vijmë deri në përfundim se ngjyrë lokale është ngjyra me të cilën janë të ngjyrosura disa bimë, dukuri ose sende që i njohim. Ajo që ka ngjyrë lokale nuk mund ta paramendojmë me ngjyrë tjetër përveç me ngjyrën e saj lokale. Për shembull: bananen nuk mund ta paramendojmë si ngjyrë vjollce ose të zezë, portokallin të kaltër apo vjollce, shalqirin të kaltër etj.

Për dallim nga e kaluara, subjektet që nuk kanë ngjyrë lokale mund t'i paramendojmë në të gjitha ngjyrat siç janë: automjetet, biçikleta, veshmbathja, lodrat, lapsat, çantat etj.




Kontrast komplementar

Ngjyrë lokale



Ngjyrë lokale, vepër e nxënësit



Ngjyrë lokale e dredhëzës



Ngjyrë lokale e pemës



Ngjyrë lokale, vepër e nxënësit



Ngjyrë lokale e portokallit dhe dredhëzës

TË MBAJMË MEND:

Në pikturim materiali themelor është ngjyra. Dallojmë ngjyra kromatike dhe akromatike, primare dhe sekondare, të ftohta dhe të ngrohta, kontrast dhe harmonike. Ngjyra lokale është e njohshme për ngjyrat e sendeve që na rrethojnë.

FUSHA FIGURATIVE

TEKSTURA

E kemi të njohur se piktura përbehet nga sipërfaqe të ndryshme të ngjyrosura me ngjyrë, ton, vijë, por edhe me përdorimin e teksturave të ndryshme.


Tekstura me ngjyrë fitohet kur në sipërfaqe duam të imitojmë ndonjë materie, të vrazhdë apo të lëmuar. Me atë, piktura bëhet më interesante dhe më e begatshme.

Teksturë në pikturë fitojmë me gjurmim, përdorim të materialeve për ngjyrosje në mënyra të ndryshme, varësisht nga fantazia jonë. Mund ta fitojmë me vendosje të ngjyrës më të rrallë dhe më të dendur, ngjyrë mbi ngjyrë, vizatim mbi ngjyrë, me stërpikje të ngjyrës mbi ngjyrë, me gërvishtje të ngjyrës së thatë apo ngjyrës së ujit dhe në çdo mënyrë tjetër e cila do të na bie ndër mend, a qëllimi është që të fitohet iluzion i teksturës.

Tekstura mund të na asocojë në ndonjë mur të vjetër, në koren e drurit ose ndonjë tjetër sipërfaqe interesante.




Teksturë piktorale




Teksturë piktorale



Teksturë



Teksturë piktorale

Tanja Balak: **Në gurë**, vaj në pëlhurë (teksturë)

Teksturë piktorale

TË MBAJMË MEND:

Tekstura piktorale është kur me eksperimentim në mënyra të ndryshme të punës me ngjyrën fitojmë sipërfaqe të ndryshme piktorale.

HAPËSIRA



Hapësirë reale

Njeriu lëviz, jeton dhe punon në hapësirë. Kafshët, bimët dhe sendet po ashtu janë prezentë në hapësirë. Atë e quajmë hapësirë reale. Hapësirën e ndajmë në të brendshme dhe të jashtme. Hapësira e jashtme është e hapur dhe në të mund të lëvizim pa kurrfarë pengesash. Hapësira e brendshme është e mbyllur dhe në të jetojmë, punojmë, blejmë, mësojmë ose zbavitemi të mbrojtur nga i ngrohti ose i ftohti, nga bora, shiu, era dhe nga dukuri tjera.

Artistët në veprat e tyre mundohen të paraqesin iluzion të hapësirës, respektivisht vizatimi ose piktura të marrë iluzion të afërt ose të largët.

Hapësira fitohet me përdorimin e formave më të vogla dhe më të mëdha, me ngjyra të ngrohta dhe të ftohta, me bashkim dhe me perspektivë.



Iluzion i hapësirës me ngjyrë dhe perspektivë



Perspektivë e dhomës



Vinsent van Gog: **Kafene e natës**, vaj në pëlhurë (perspektivë)



Jakopo Tintoreto, vaj në pëlhurë (perspektivë)



Leonardo da Vinçi: **Darka e fundit**, freska

TË MBAJMË MEND:

Në pikturim iluzion të hapësirës fitojmë me forma më të mëdha dhe më të vogla, me ngjyra të ngrohta dhe të ftohta, me bashkim dhe me perspektivë.


AKUAREL

Akuareli është teknikë e pikturimit me ujë me të cilën pikturojnë artistët dhe nxënësit. Ngjyra përzihet me ujë të zakonshëm dhe me ndihmën e brushës vendoset në anën e vrazhdë të letrës. Me akuarel fitohen shtresa të lehta, të ndejshme dhe të tejdukshme të ngjyrës, për dallim nga temperi. Gjatë pikturimit duhet të përdoret më tepër ujë me çka fitohet tejdukshmëri e ngjyrave.

Për punë na janë të nevojshme bllok për vizatim, ngjyra akuarel dhe brusha të buta me maje të mprehtë. Vizatohet me majën dhe pjesën e mesme të brushës me shënime të lehta dhe të shpejta të ngjyrës. Para se të fillojmë të pikturojmë në hapësirën e punës vendosim letër të gazetave, po ashtu na janë të nevojshëm edhe dy enë të mëdha për ujë për t'i pastruar brushat, respektivisht një për ujë të pastër e tjetra për ujë të papastër.

Ujin në enë duhet sa më shpesh ta ndërrojmë me ujë të pastër që të mundemi të fitojmë vepër me ngjyra më të bukura dhe më të pastra.

Me akuarel më së miri është të pikturojmë drejtpërdrejt me brushë, pa vizatuar me laps, punohet prej në të majtë nga e djathta dhe prej lart nga poshtë.



Akuarel



Pajisje për akuarel

Pol Sezan: **Autoportret,**
akuarel

Akuarel

TE MBAJMË MEND:

Akuarel është teknikë e pikturimit. Ngjyra përzihet me ujë, pikturohet në letër të vrazhdë me brushë.

PASTEL ME DYLLË



Vepër e nxënësit, pastel me dyllë


Pasteli me dyllë është material me të cilin mund të vizatohet dhe pikturohet. Ai është në gjendje të ngurtë, ka formë të shkumësit dhe drejtpërdrejt në sipërfaqen për pikturim. Si bazë për punim kemi letër të vrazhdë.

Për t'u fituar efekte më interesante gjatë pikturimit, mund të përdorim letër të ngjyrosur.

Me materialin pikturojmë drejtpërdrejt në letër me një shtresë, por mund të vendosim ngjyra njëjën mbi tjetrën në disa shtresa. Pas vendosjes së disa shtresave, veprën mund ta gërvishtim me mjet të mprehtë dhe në atë mënyrë fitohen efekte dhe kombinime interesante.



Vepër e nxënësit, pastel me dyllë



Vepër e nxënësit, pastel me dyllë



Vepër e nxënësit, pastel me dyllë



Vepër e nxënësit, pastel me dyllë



Vepër e nxënësit, pastel me dyllë



Vepër e nxënësit, pastel me dyllë



Vepër e nxënësit, pastel me dyllë

FUSHA FIGURATIVE

72

Në klasat tjera u njoftuam me skulpturën si një nga fushat figurative në të cilën veprat figurative marrin pjesë të hapësirës, respektivisht janë tredimensionale. Për dallim nga skulptura, vizatimi, piktura dhe grafika janë dydimensionale.

E dimë se veprat në këtë fushë ndahen në plastikë të plotë dhe relief. Plastikë e plotë është vepër e cila është e vendosur dhe qëndron në hapësirë të hapur apo të mbyllur dhe mund të vështrohet nga të gjitha anët.


Këto vepra janë statike, por ka edhe plastikë të plotë e cila nuk është pasive dhe e ndryshon formën e vet. Skulptura e cila nuk është statike quhet *mobil*.

Relievi është vepër e cila çdo herë është e vendosur në ndonjë sipërfaqe të murit si dekorim i objekteve publike dhe reprezentative ose përmendore të tjera.

Dallojmë relief të thellë, të lartë dhe të cekët (bareliev).



Vëllai i të vdekurit, Egjipt
(reliev i cekët)



Detal nga ikonostas, kisha Sv.
Spas

Luka de la Robija: **detal nga reliefi, relief i lartë**




Gjuajtës i diskut, Romë, mermer
(plastikë e plotë)



Portret i Amen Hotep, Egjipt
(reliev i thellë)





Aleksandar Kalder: **Tavan akustik**, mobil



Keti Kolvic: **Autoportret**, bronzë



Perëndeshë e dimrit, Krit, terakota:

Reliev i cekët është kur kemi thellime të vogla në format e paraqitura. *Reliev i thellë* themi kur format janë të paraqitura me thellime të pllakës së relievit, por në rast se kemi skulptura të theksuara të cilat vetëm me një pjesë janë të lidhura me pllakën themi se ai është *reliev i lartë*.

Nëse shëtisim në qytetin tonë apo në qytete tjera të botës, shpeshherë do të takohemi me vepra figurative të skulpturës. Ato janë të vendosura që të paraqesin ndonjë ndodhi, të shënojnë ndonjë ngjarje ose ta përkujtajnë figurën e ndonjë personi të merituar nga historia ose e tashmja.

Nëse këtë lloj vepre e paraqet vetëm portreti i njeriut me pjesën e sipërme të trupit, këtë vepër e quajmë *bust*. Ato janë përmendore të personave me merita të cilët i mbajmë mend sipas meritave të tyre. Kemi buste të heronjve nacional, të revolucionarëve, shkencëtarëve, shkrimtarëve por edhe të qytetarëve të zakonshëm.



Boro Mitrikeski: **Kirili dhe Metodi**, bronzë



Dushan Xhamonja: **Përmendore memoriale e Kozarës**, beton

TË MBAJMË MEND:

Skulptura është fushë figurative. Ndahet në plastikë të plotë dhe reliev. Mobil është skulpturë e lëvizshme. Dallojmë reliev të thellë, të lartë dhe të cekët. Busti është skulpturë e cila paraqet portret të njeriut.

FUSHA FIGURATIVE

74

Nëpër sheshe dhe në vende publike shpeshherë shohim skulptura të cilat paraqesin ndonjë ndodhi nga historia apo ndonjë njeri të njohur në madhësi natyrore ose më të mëdha.

Këto objekte i quajmë *përmendore*. Me to i nderojmë ngjarjet e rëndësishme dhe personat me merita.

Më së shpeshti përmendoret janë të punuar nga guri ose nga bronzi dhe jeta e tyre është e pakufizuar.

Veprat e skulptorëve krijohen nga materiale të cilët janë stabile dhe rezistente ndaj kushteve klimatike. Më së shpeshti veprat janë të krijuara nga *terakota, guri, druri, bronzi dhe metali*, po ashtu mund të punohen edhe nga *plastika, letra, stiropori*, si dhe nga materialet tjera – mbeturina.



Zharko Bashevski: **Përmendore e Aleksandrit të Madh**, bronz



Petre Nikolovski: **Objekt HHHIII 92**, instalim



Stefan Manevski: **Çast i kohës**, metal



Tutankamon, Egjipt, skulpturë e ngjyrosur



M. Aristid: **Sputana akcija**, bronz

FUSHA FIGURATIVE

75




Marijeta Sidovska: **J'am looking for a men in a mirror**, teknikë e kombinuar.



Vepër e fëmijëve me letër



Intervenim në hapësirë



Vladimir Avramçev: **Krahina VIII**, qeramikë

Mënyra e ndërtimit të veprës skulpturale është i ndryshëm varësisht nga dëshirat e autorit dhe zgjedhjes së materialit. Me argjilë modelohet duke shtuar dhe hequr, me metal dhe bronz me përpunim duke plotësuar dhe kombinuar forma të ndryshme të cilat ngjiten së bashku. Me plastikë, letër dhe stiropor ndërtohet skulpturë nëpërmjet bashkimit, thyerjes, prerjes, përforcimit dhe ngjitjes.

Me mbeturina krijohet asamlazh, respektivisht skulpturë grupore në të cilën kombinohen materiale të ndryshme në një tërësi sipas idesë së autorit.

Në skulpturë nuk ka kufizim për përdorim të materialeve. Disa autorë shprehen duke kombinuar fryte të ndryshëm, degë, gurë, rrënjë dhe materiale tjera sipas dëshirës.



Robert Smitson: **Mbyllja e rrugës**, teknikë e kombinuar

TË MBAJMË MEND:

Përmendore është skulpturë e cila shënon njerëz të shquar nga sfera të ndryshme ose ngjarje historike. Veprat skulpturore punohen prej: terakote, guri, druri, bronzi, metali, por mund të krijohen edhe nga plastika, letra, stiropori dhe nga materialet e të tjera.

FUSHA FIGURATIVE

76


FORMA

Forma është shprehja kryesore në skulpturë sepse ajo e potencon formën tredimensionale të veprës. E dimë se skulptura përfshin një pjesë të hapësirës, dhe atë hapësirë e quajmë *vëllim*.

Vëllimi sipas pamjes mund të jetë me *kënde, cilindrik ose i rrumbullakët, i theksuar ose i thelluar*.

Në lidhje me hapësirën, forma mund të jetë e *mbyllur, e hapur ose e perforuar*.

E mbyllur është ajo formë e cila është e plotë dhe hapësira nuk ndërhyr në të, për shembull: top, mollë, gurë, kub etj. Formë e hapur është ajo formë në të cilën hapësira pjesërisht hyn në vëllim, për shembull: gotë, vazo, qyp, kapelë, tenxhere etj. Formë të perforuar e quajmë atë formë apo vëllim në të cilën ekzistojnë vrima më të mëdha apo më të vogla, për shembull: zinxhir, byzylyk, thurje, etj.




Alberto Xakometi: **Paletë prej teli**, tel



Stanko Pavlevski: **Skulpturë**, metal



Branko Veličkovski: **Torzo**, terakota



Vencislav Rihter: **Formë centrale**, metal

TË MBAJMË MEND:

Forma mund të jetë e hapur, e mbyllur dhe e perforuar. Vëllimi është hapësira e cila e përfshin ndonjë skulpturë e caktuar. Dallojmë relief cilindrik, këndor, të theksuar dhe të thelluar.

KONTRAST

Kontrasti si parim në gjuhën figurative shpeshherë aplikohet për ta zbukuruar veprën e artistit. Kontrasti përdoret në vizatim, fotografi, grafikë dhe skulpturë.


Në skulpturë gjatë modelimit dhe komponimit të më shumë pjesëve në një tërësi me qëllim përdoren forma të mëdha dhe të vogla, cilindrike dhe këndore, tekstura të vrazhda dhe të lëmuara. Me kontrast artisti e pasuron vlerën figurative të veprës dhe kënaqësinë e vizituesit.



Dushan Xhamonja: **Skulptura 45**,



Hans Arp: **Kokë**, mermer i bardhë



Hain Stenbak: **Pa titull**, teknikë e kombinuar



Henri Mur: **Familje**, bronz

TË MBAJMË MEND:


Parimi figurativ kontrast aplikohet në skulpturë me përdorimin e formave të thelluara dhe të theksuara, të mëdha dhe të vogla, po ashtu edhe me teksturë të lëmuar dhe të vrazhdë.

FUSHA FIGURATIVE

78

PROPORCION

Me proporcionin u njoftuam në gjuhën figurative. Në skulpturë më së shpeshti është prezente dëshira që të gjendet *bukuri ideale* e asaj që paraqitet, ajo zakonisht bie në figurën e njeriut dhe trupin e tij. Bukuria paraqet proporcione ideale të gjitha pjesëve të njeriut. Secili artist i cili pretendon nga e bukura e aplikon këtë parim, por e dimë se këtë problem e kanë zgjedhur edhe skulptorët në Greqinë e Vjetër, e në kohën më të re, edhe Leonardo da Vinci.



Kanon për proporcion të njeriut, Greqi

Mikelanxhelo: **Mojseu**, mermerMikelanxhelo: **David**, mermer**TË MBAJMË MEND:**

Në skulpturë arrihet proporcion ideal i pjesëve në një tërësi. Shembull janë skulpturat greke.

ARGJILË



Vegël për modelim me argjilë



Punim me argjilë



Figura të poçarisë



Aneta Svetieva: Zhytëse, terakota

Argjila është material me të cilin secili skulptor e fillon punën e tij. Me të mund të krijohen formohet secila formë dhe ide e artistit. Modelohet në mënyrë të lehtë duke shtuar dhe larguar dhe me ngjitje të materialit.

Punohet me duar ose me vegla të ndryshme të quajtur *shpahtla*.

Skulptura e punuar me glinë nuk mund të mbetet përherë në këtë material për shkak se do të fillojë të derdhet nga ndikimi i lagështisë në ajër.

Nëse dëshirojmë ta ruajmë veprën në argjilë, argjilën duhet ta pjekim në temperaturë të lartë dhe në atë mënyrë të shndërrohet në terakota, argjilë e pjekur. Terakota është e ngjashme me prodhimet e poçarisë.

Në praktikë artistët më së shpeshti prej veprës në argjilë bëjnë kallëp prej të cilit formohen më tepër skulptura identike në bronz apo ndonjë metal tjetër.



Portret prej argjile



Sarkofagu nga Cerveteri, Terakotë e ngjyrosur



Terakota

TË MBAJMË MEND:


Argjila është material për skulpturë me të cilën modelohen veprat figurative. Punohet me gishta dhe me shpahtlla. Pjekja e argjilës quhet terakota.

FUSHA FIGURATIVE

Tani më u njoftuam me dizajnin si fushë figurative në të cilën artistët figurativ e bëjnë dukjen e sendeve për përdorim të përditshëm. Duket e sendeve për përdorim të përditshëm e bëjnë artistët – *dizajnerë*. Në të, krahas gjithë të tjerave bëjnë pjesë edhe stolitë si dhe sende të ndryshme zbukuroese. Sot rreth nesh ndodhin shumë gjëra për të cilat kemi dëshirë të kuptojmë ku dhe kur kanë ndodhur, të jemi të informuar që ta zgjedhim atë që na intereson. Atë e arrijmë me mjetet për *komunikim vizual*. Gjithë ajo që na informon me ngjyrë apo me formë, është komunikim vizual, për shembull: *shenja komunikacioni, placate, posterë, pamflete, bilborde, revista, gazeta, shenja të mbrojtura etj.*



Dizajn i lodrës për fëmijë



Makinë shkrimi



Dizajn i llambës elektrike



Televizor



Kolltuk

FUSHA FIGURATIVE



Stoli



Stoli



Automjet



Kitarë



Kopertinë reviste për fëmijë

FUSHA FIGURATIVE

82

Nëpërmjet kopertinave të librave e njohim dhe e zgjedhim përmbajtjen që dëshirojmë ta lexojmë. Me kartolinat komunikojmë dhe i urojmë festat e ndryshme dhe momentet e bukura të jetës sonë.

Sikurse në secilën fushë figurative, artistët figurativ të cilët dizajnojnë komunikime vizuale shumë mirë e njohin gjuhën figurative dhe e aplikojnë në punën e tyre artistike. Përdoret forma, vija, toni dhe ngjyra si element për ta tërhequr njeriun.

Harmonia, kontrasti, proporcioni dhe kompozimi janë prezent në secilin dizajn.



Dizajn i CD Ilustrim



Pllakat



Ilustrim




Ilustrim



Kësulëkuqja

FUSHA FIGURATIVE



Kopertinë për revistë për fëmijë




Kopertinë për libër



Iniciale për shkronjën O



Flamuri i Republikës së Maqedonisë



Pllakat për 100 vjet pavarësi të Maqedonisë



Bilbord

TË MBAJMË MEND:


Dukjen e sendeve për përdorim e bëjnë artistë të quajtur dizajner. Të gjitha mjetet me të cilat informohemi për atë që ndodh rreth nesh quhet komunikim vizual.

E dimë se grafika fitohet me anë të shtypjes. Në vizatim, pikturim dhe skulpturë fitojmë vetëm një vepër me kreacion të drejtpërdrejtë. Në këtë fushë, me proces të veçantë të punës, mund të shtypim grafika të njëjta në më shumë kopje.


Që të bëjmë grafikë, së pari duhet të zgjedhim bazën të cilën do ta përgatisim për shtyp. Bazën që e përpunojmë paraqet *matricë* ose *klishe* me të cilën shtypet grafika. Për matricë mund të përdorim karton, pllakë linoleumi, gjips, dru, gurë ose metal, varësisht prej asaj se në cilën teknikë duam të punojmë.

Në matricën për shtyp e vizatojmë idenë tonë për grafikë. Nëse për bazë kemi linoleum, gjips ose dru, së pari e vizatojmë vizatimin me ngjyrë të zezë.


Kur vizatimi do të jetë gati, me vegla speciale për gdhendje (daltë) i nxjerrim sipërfaqet e bardha të vizatimit, ndërsa të zezat mbesin në sipërfaqe. Me atë matricë është e përgatitur për shtyp.




Makina grafike për shtyp




Gdhendje në matricë të linoleumit



Vendosja e ngjyrës në matricë



Shtypja e grafikës



Nxjerrja e grafikës



M. Aristid: **Bari**
Koridon, gdhendje në dru



Albreht Direr: **Sv. Toma**,
gravura



Rembrant: **Portret i Jan
Lutie Postariot**, shënim në bakër

Etapa e dytë është procesi i shtypjes së *fletës grafike*. Në një sipërfaqe të plastikës, qelqit apo të metalit, vendosim ngjyrë për shtyp, mundet edhe temperë, dhe me cilindër e vendosim matricën. Kur të vendosim ngjyrë, në klishe me kujdes vendosim letër të cilën prej sipër e shtypim me dorë ose ndonjë mjet cilindrik.

Kur letra të bie mbi sipërfaqe me gjithë sipërfaqen e saj, dhe shohim se ka absorbuar ngjyrë nga matrica, ngadalë e largojmë prej saj. Me këtë hap grafika jonë është shtypur.

Në këtë mënyrë mund të shtypim fleta grafike sa të duam.



Matricë dhe gjurmë prej linogdhendje

TË MBAJMË MEND:

Grafika është fushë figurative. Veprat figurative në grafikë fitohen me shtypje të më tepër grafikave të njëjta. Matrica ose klishe është baza me të cilën shtypet. Dalta është vegla për përpunim të matricës.


NËNSHKRIM NË GRAFIKË

Grafika si vepër figurative ka vlerë vetëm nëse është e nënshkruar nga autori. Fleta nënshkruhet në pjesën e poshtme horizontale të gjurmës. Së pari vihet numri rendor i grafikës së shtypur dhe numri i plotë i grafikave të shtypura. Për shembull: nëse grafika që e kemi shtypur është e treta me radhë, dhe gjithsej kemi nëntë grafika të njëjta, numri do të jetë 3/9.

Menjëherë pas numrit shënohet teknika me të cilën është shtypur vepra, për shembull: karton-shtyp, gjips-gdhendje etj, pas teknikës shënohet viti kur është shtypur grafika, për shembull: 2010.

Në mes të vijës së poshtme shkruhet titulli i grafikës, për shembull: dru, peizazh, portret etj., e në anën e djathtë vendoset nënshkrimi i autorit që e ka krijuar grafikën.

Me nënshkrim, grafika bëhet vepër e autorit dhe merr vlerë artistike. Autori çdo herë duhet t'i nënshkruajë veprat e veta në këtë mënyrë.



3/9, sito-shtyp, 1990

Alfa II

Danço Ordev


TË MBAJMË MEND:

Secila grafikë nënshkruhet prej autorit. Me nënshkrim grafika bëhet vepër origjinale figurative.

VIJA

Vija posaçërisht në grafikë, si dhe në vizatim është element kryesor për shprehje. Pasurinë e grafikës e fitojmë me shfrytëzimin e vijave të ndryshme, të trasha, të holla, të gjata, të shkurta, të drejta dhe të lakuara.

Më vijë e shprehim atë që duam ta paraqesim së bashku me formën nëpërmjet të cilave i njohim sendet e paraqitura.



Milan Sokol: **Kaptina I**, gdhendje në linoleum



Rruga qarkore, gdhendje në dru, autor i panjohur



Dimçe Nikolov: **Krahina XXI**, shënim në bakër



Ilija Kočovski: **Shënime**, gdhendje në dru



Vijë në grafikë



Pablo Pikaso: **Piktor me model që qëndis**, gdhendje në bakër

TË MBAJMË MEND:

Grafika më së shpeshti paraqitet nëpërmjet pasurisë dhe shumëllojshmërisë së vijave.

TEKSTURA

Element tjetër figurativ i cili po ashtu është i rëndësishëm është tekstura. Me teksturë i përcaktojmë karakteristikat e formave dhe sipërfaqeve të ndryshme në njohjen e ndërsjellë. Teksturën e fitojmë me thellim dhe prerje të matricës me lloje të ndryshme të teksturës, të cilën e fitojmë nga llojet e ndryshme të vijave dhe pikave, dendësisë së tyre dhe kahjet e ndryshme të vendosjes. Nëse analizojmë ndonjë prej grafikave dhe teksturave të paraqitura në këtë libër, do të shohim se në shikim të parë do t'i shohim dallimet mes formave me ndihmën e teksturës së tyre.



Piter Brojgel: **Në gjueti**, shënim në bakër

TË MBAJMË MEND:

Tekstura është mjet themelor i shprehjes në çdo grafikë.



Ordan Petlevski: **Memento**,
Gdhendje në dru



Dragan Bikov: **Bërthamë**,
Teknikë e kombinuar



Burhan Ahmeti: **Fragmente vjeshtore**, akuatinta

FORMA

E tërë ajo që paraqitet në grafikë mund ta dallojmë sipas formës së saj.

Formën e paraqesim me ndihmën e vijës, teksturës dhe ndonjëherë me ndihmën e ngjyrës.

Në grafikë sikurse në fushat tjera figurative me bukurinë e formave paraqesim idenë tonë dhe atë që duam ta shprehim.



Basra Mekoli: **Krijimi i jetës**, grafikë digjitale




Sito-shtyp



Sito-shtyp



T. Kauzariq: **Katrör D**, Sito-shtyp



Sito-shtyp

TË MBAJMË MEND:

Më grafikë forma definohet me vijën, ngjyrën dhe llojllojshmërinë e teksturës.

Në orët e artit figurativ, pak nga pak e mësojmë gjuhën figurative me elementet dhe parimet e saja karakteristike në veprat tona, dhe njëkohësisht të njëjtat t'i njohim në veprat e artistëve figurativë botërorë dhe vendas.

Duke u shprehur figurativisht dhe duke shikuar vepra të vlefshme, ne fituam aftësinë të përcaktojmë çfarë është mirë e çfarë jo.

Estetika është shkencë për të bukurën.

Me çështjen e të bukurës janë marrë shumë filozofë, artistë dhe estetikë me qëllim që të arrijnë deri te thelbi i vlerave në veprën artistike në të gjitha fushat e arteve. Me ndihmën e arsimtarit tuaj të artit figurativ, nëpërmjet bisedave për veprat tuaja, për veprat figurative, njëkohësisht aftësoheni të përcaktoni çfarë është e vlefshme e çfarë jo në një vepër artistike figurative.

Vlerësim estetik mund të bëni për secilën vepër nga secila fushë figurative, të vizatimit, pikturës, skulpturës, grafikës apo dizajnit.

Duke shikuar një vepër figurative secili prej nesh e shikon si vlerë figurative e cila çdo herë në ne ngjall ndjenja pozitive dhe kënaqësi, në mënyrë vizuale, mendore dhe emocionale. Krahas vlerës figurative dhe paraqitjes teknike, në ndjenjat tona ndikon edhe kombinimi i ngjyrave, toni, vijat, format ose përmbajtja, respektivisht motive.

Ndjenja mund të jetë individuale varësisht nga personi që e shikon.



SHEMBULL 1

Vinsent van Gog: Shtëpi e verdhë, tush, pendë

Duke e shikuar vizatimin e Van Gogut, mund t'i shohim kualitetet e vizatimit në vijim:

- Në vizatim shohim përdorimin e vijave dhe pikave të ndryshme në dendësi dhe në madhësi të ndryshme.

- Format në vizatim, shtëpia, rruga, qielli, druri në mënyrë të qartë janë të ndara njëra prej tjetrës, për të cilat artisti ka përdorur vija të ndryshme për secilën prej tyre, respektivisht teksturë karakteristike të ndryshme. Në shikim të parë të gjitha format shihen qartë.

- Teknikisht, vizatimi duket pastër, qartë, thjeshtë dhe preciz.

- Secili prej nesh mund ta përjetojë emotivisht në mënyrë të ndryshme atmosferën e vizatimit. Dikush do ta përjetojë si rrugë e qetë në mbrëmje, para se të ndizen kandelat, dikush mund ta përjetojë si herët në mëngjes kur njerëzit dalin nga shtëpitë e veta etj.



Vinsent van Gog: Shtëpi e verdhë, tush, pendë

SHEMBULL 2

Ordan Petleski: Rajon i djegur, vaj në pëlhurë

Duke e analizuar pikturën e Ordan Petleskit, mund të vërejmë:

- Artisti në pikturën e vet është shprehur me bukurinë pikturuese të ngjyrës së teksturës. Me veprime të ndryshme ka fituar teksturë të begatshme. E shohim se ka përdorur ngjyra të ngjashme dhe kontrast: ndritshëm-errët në pjesë të caktuara me të cilat i ka potencuar format.
- Trajta e formës është e lakuar dhe e kombinuar me madhësi të ndryshme.
- Ka shfrytëzuar ngjyra të ngjashme me të cilat piktura duket e qetë dhe harmonike.
- Edhe pse në pikturë nuk ka motiv të caktuar, me kënaqësi mund ta shikojmë dhe të kënaqemi me pikturën.



Ordan Petleski: **Rajon i djegur**, vaj në pëlhurë

SHEMBULL 3

Piter Brojgel: Në gjueti, shënim në bakër, grafikë

Duke e shikuar grafikën e Piter Brojgelit, i shohim këto vlera:

- Artisti ka përdorur kombinim të vijave të ndryshme, pika dhe tekstura. Grafika duket pastër, qartë, thjeshtë dhe preciz.
- Format e paraqitura në motiv, shtëpitë, druri dhe njerëzit, vizuelisht janë të ndara njëra prej tjetrës me teksturë të ndryshme dhe errët-ndritshëm.
- Me forma më të vogla dhe më të mëdha të drunjve dhe shtëpive dhe me sipërfaqe më të errëta dhe më të ndritshme të teksturës e ndjejmë hapësirën, respektivisht kemi iluzion afër dhe larg.
- Teknikisht vërejmë se gjurma është e pastër dhe e qartë.
- Nëse grafikën e shikojmë me kujdes, secili prej nesh mund të gjejë përbajtje me të cilën mund të tregohet një tregim.



Piter Brojgel: Në gjueti, shënim në bakër, grafikë

SHEMBULL 4

Mikelanxhelo - Roden: skulpturë

Duke e analizuar skulpturën e Umberto Boçoni, mund të shohim:

- Artisti, skulpturën e ka përpunuar me vëllim me madhësi të ngjashme dhe forma të rrumbullakëta-cilindrike të ngjashme.
- Forma e skulpturës është moderne, mirëpo prapë se prapë asocon në figurë njeriu e cila lëviz, edhe pse nuk është e paraqitur në mënyrë reale.

- Asocioni i figurës në lëvizje është arritur me format që janë dinamike dhe na asocojnë në ritëm në hapësirë. Duke i shikuar format, ato vizuelisht na sugjerojnë sikur gjithë figura të lëvizë para.

- E gjithë skulptura është harmonike dhe e përjetojmë si bashkësi të vëllimit.

- Siç duket, artisti e ka punuar me bronz dhe me ngjyrë të verdhë që të arrijë më shumë ndjenjën e dinamikës dhe të ritmit. A thua me ngjyrë tjetër do ta arrinte këtë ndjenjë?



Mikelanxhelo - Roden:
Skulpturë

SHEMBULL 5

Pllakat për 100 vjet pavarësi të Maqedonisë, dizajn

Këtë pllakat R. e Maqedonisë e publikoi me rastin e 100-vjetorit të kryengritjes së Ilindenit. Pllakati duhet ta prezantojë luftën tonë për Maqedoni të pavarur.

Pllakati, njerëzve duhet t'u paraqesë përmbajtjen e porosisë për të cilën është krijuar. Nga ky pllakat mund të kuptojmë:


- Simboli kryesor, flamuri ynë, është prezantuar në pllakat, me të cilin menjëherë e shohim se pllakati transmeton porosi për shtetin.

- Pllakati është i mbushur me simbole.

- Në qendër është prezantuar përmendorja Makedonium, vendi ku ka lindur Kryengritja e Ilindenit. Pjesa e mjegulluar paraqet largësinë prej 100 viteve. Pas Makedoniumit paraqitet dielli si simbol i dritës dhe lirisë, ndërsa prej qendrës, nëpër gjithë pllakatin valon flamuri i Maqedonisë.

- Gjithë pllakati është i ngjyrosur me ngjyrat nacionale të Maqedonisë.

- Përveç porosisë, e cila vizuelisht na paraqitet, kemi edhe tekst i cili në mënyrë tekstuale na sqaron për cilin rast është botuar pllakati.



Pllakat për 100 vjet pavarësi të Maqedonisë, dizajn

A

Amator – dashamir i artit i cili ka profesion tjetër, por merret edhe me krijim të veprave figurative prej dashurisë e jo profesionalisht.

Animalist – artist figurativ i cili merret me paraqitjen, respektivisht me vizatimin ose skulpturimin e kafshëve.

Antika – term i kulturave të vjetra, sidomos i kulturës romake dhe greke

Arti abstrakt – drejtim i artit modern, i cili e braktis paraqitjen e botës reale dhe krijon me forma të lira

Arabeska – ornament në stil arab i cili përbëhet nga elemente gjeografike dhe bimore

Atelie – punëtori, vend pune i artistit figurativ ose i njerëzve me profesion kreativ.

Ambalazh – dizajnim figurativ i materialit me të cilin mbështjellin prodhime

B

Bareliev – reljev shumë i ulët, i cekët në skulpturë

Bienale – ekspozitë e cila mbahet çdo dy vite.

Bust – paraqitja e kokës dhe pjesës së sipërme të trupit të njeriut në skulpturë

V

Valer – fjalë për ton në gjuhën frënge.

Vinjeta – vizatim apo pikturë e vogël e cila shërben si zbukurim i ndonjë teksti.

Vitrash – dritare apo sipërfaqe e qelqit, e punuar ose zbukuruar me pjesë të qelqit me ngjyra të ndryshme

G

Galeri – objekt i ndërtuar me qëllim që të ekspozohen vepra artistike

Gvash – teknikë për vizatim me ngjyra uji dhe me temperë të bardhë

Fletë Grafike – vepër grafike figurative e shtypur

Skulpturë Galerie –

Skulpturë e cila me madhësinë e saj mund të ekspozohet në galeri (madhësi reale ose miniaturë)

D

Dekoracion – zbukurim, respektivisht zbukurim i hapësirës, si dhe i formave tjera të zbukurimit

Dizajn – vizatim i kushtuar për formim të prodhimeve për prodhimtari industriale

Dizajner – artist, specialist për formim estetik të sendeve ose sipërfaqeve për prodhimtari industriale.

Zh

Zhanër – paraqitje e pikturave nga jeta e përditshme nëpërmjet veprave figurative.

I

Ilustrim – pikturë ose vizatim lidhur me ngjarje nga teksti

Histori e artit – shkencë për paraqitjen dhe zhvillimin e drejtimeve artistike, vlerën e tyre dhe rëndësinë historike

Iluzion – iluzion në pikturim është paraqitja e hapësirës, tonit, perspektivës etj.

Dizajn industrial – formim figurativ i sendeve për përdorime të përditshëm të cilat prodhohen në industri.

K

Katalog – publikim në të cilin janë të shënuara të gjitha veprat e ekspozuara të muzeut, galerisë, ekspozitës apo krijimtarisë.

Kiç – zeje joartistike ose produksion joartistik. Kiç është vepër e cila krijohet për shkak të dëshirës së popullaritetit të lirë, paraqitet si rezultat i mesit të pazhvilluar artistikisht.

Kolorit – efekt i veprës artistike e arritur me ngjyrë.

Kroki – vizatim i shpejt dhe i lehtë me vija të thjeshta dhe pak detaje.

L

Ngjyrë Lazurë – vendosje e ngjyrës së tejdukshme nëpërmjet së cilës mund të shihet baza.

Art Figurativ – emër i përbashkët për arkitekturë, pikturim, skulpturim dhe grafikë, vepra të cilat i krijon njeriu në mënyrë kreative.

Lineare – karakteristikë e veprës pikturale, skulpturore ose grafike në të cilën mjet kryesor i shprehjes është vija.

M

Marina – paraqitje artistike e peizazhit detar.

Miniaturë – pikturë ose skulpturë në formë të vogël.

Mozaik – vepër artistike e cila punohet me bashkimin e kubeve me ngjyra të ndryshme të qelqit, gurit etj.

Monografi – libër në të cilin janë përshkruar jeta dhe vepra e ndonjë artisti.

Monokromi – vepër pikturimi e punuar vetëm me një ngjyrë.

N

Natyzalizëm – përpjekje e artit, dukuritë dhe subjektet të paraqiten më të realta.

O

Ornament – forma të stili-zuara gjeometrike, bimore ose zoomorfe me të cilat është zbukuruar ndonjë rrafsh, të cilat mund të përsëriten apo të ndryshojnë.

Mbështjellës – formësim figurativ, dizajnim i kopertinave për libra ose material tjetër reklamues.

P

Paletë – sipërfaqe në të cilën poeti i përzien ngjyrat para se t'i vendos në vepër.

Panorama – paraqitja e natyrës me pikëpamje të gjëra dhe të largëta.

Peizsazh – pikturë në të cilën paraqitet natyra.

Art i zbatueshëm – emër i subjekteve të formësuara në mënyrë artistike për përdorim.

Profil – pamje e fytyrës ose subjektit shikuar prej anash.

R

Shtyp i rrafshët – teknikë grafike pa thellësim të bazës (sito-shtyp, monotipi, litografi)

Grafika reproduktive – kopje ose vepra të cilat nuk janë të shtypura me dorë por me offset shtyp industrial.

S

Signatura – nënshkrim personal i artistit në pikturë, grafikë apo skulpturë të cilën e ka punuar.

Skica – pikturë, vizatim, skulpturë apo ndërtim i padekoruar.

Stilizim – thjeshtësim i formave nga natyra në forma themelore të thjeshta.

T

Tapiceri – emër i veprës artistike i punuar me materiale të tekstitit.

Terakota – emër për prodhime nga argjila të cilat janë të forcuara me pjekje.

Triptik – vepër figurative e formuar nga tre pjesë.

F

Faktura – sipërfaqja e veprës artistike në pikturim me të cilën fitohen disa karakteristika të sipërfaqes.

Figurativitet – karakteristikë e veprës figurative kur në të mundet të shihet figurë konkrete, përmbajtje apo motiv.

S

Vizatim – vepër figurative e krijuar në sipërfaqe e krijuar mi vijë si mjet kryesor i shprehjes.

Sh

Shtafelaj – mbajtës për pikturim, këmbëza në të cilat artisti e vendos pikturën gjatë punimit.



Nxënës i dashur,

Kur të mbërrish deri tek këto teste, veç se je i njoftuar me pjesën më të madhe të përmbajtjes të këtij libri. Deri më sot me siguri ke mësuar shumë gjëra të panjohshme, por disa edhe i di dhe je i njoftuar. Këto teste janë vetëm kontrollim i diturive tua.

Disa pjesë të testit janë me përgjigje të pyetjeve të parashtruara, e disa zgjidhen me vizatim.

Shpresoj që testet nuk janë të rënda dhe pa mund të madh do t'i zgjidhësh.

Testet do t'i plotësosh atëherë kur të vendosë arsimtari i artit figurativ, të parin nga fundi i gjysmëvjetorit të parë, e të dytin nga fundi i gjysmëvjetorit të dytë.

Përgjigjet e secilës pyetje do të jepen me pikë, të cilat do t'i përcaktojë arsimtari i artit figurativ.

Të dëshiroj zgjidhje të suksesshme të testeve, nota të mira dhe kënaqësi gjatë punës.

TEST 1

EMRI DHE MBIEMRI _____

KLASA _____

SHKOLLA _____

DATA _____

1. Numëroji elementet figurative:

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____

2. Numëroji parimet figurative:

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____

3. Numëroji fushat figurative:

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____

4. Vizato teksturë

me vija	dhe pikë

5. Vizatoji këto forma:

të hapur	të mbyllur	të perforuar

TEST 1


100

6. Ngjyrosi sendet me ngjyra lokale.

banane	shalqi	limon	portokall

7. Përcakto cilës kahje i përket vizatimi në vijim:

e pjerrët horizontale vertikale



8. Vizato forma pa kahje.

9. Vizato forma statike.

10. Vizato iluzion në hapësirë me ndërhyrje.

EMRI DHE MBIEMRI _____

KLASA _____

SHKOLLA _____

DATA _____

1. Cila prej këtyre veprave të pëlqen më shumë?



Danco Kalcev
Natyrë e vdekur

Me motiv



Ordan Petlevski
Djegje

Apstrakte

2. Vizato vepër me simetri.

3. Paraqit gradacion të formës.

TEST 2

102

4. Vizato ritëm rregullar.

5. Vizato ritëm alternativ.

6. Vizato vepër me motiv sipas dëshirës.

7. Vizato vepër pa motiv.

8. Numëro tre shembuj të dizajnit.

- _____
- _____
- _____

9. Numëro tre shembuj të komunikimit vizual.

- _____
- _____
- _____

